



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

Raport i zgjedhjeve komunale 2009

The collage features several election-related documents. On the left, a blue ballot paper titled 'ZGJEDHJET PËR KUVENDIN KOMUNAL' and 'IZBORI ZA SHKUPËNIN DËN OPŠTINE BELEDIJE MEGLISË (SEÇIMLERI)' is visible. In the center, a yellow ballot paper for 'IZBORI ZA GRADONAČELNIKA OPŠTINE 2009' from Prishtinë is shown. On the right, an orange ballot paper for 'PËRSHËRTIA E VOTIMIT TË DYTË TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE 2010' from Lipjan is displayed. A magnifying glass is positioned over the yellow ballot paper, focusing on the list of candidates and their party affiliations.

Shënoni VETËM NJË kandidat - Ozaçite SAMO JEDNOG kandidata
<input type="checkbox"/> 46. AAK - ALEANCA PËR
<input type="checkbox"/> 48. PSD - Partia Socialiste
<input type="checkbox"/> 51. PDK - PARTIA DEMOKRATIKE
<input type="checkbox"/> 59. PARTIA E TË GJELBË
<input type="checkbox"/> 60.
<input type="checkbox"/> 76. AAK - ALEANCA PËR
<input type="checkbox"/> 77. LDK - LIGJERIA DEMOKRATIKE
<input type="checkbox"/> 103. PSD - PARTIA SOCIALISTE
<input type="checkbox"/> 109. KOSOVA

001. PARTIA POLITIKE A

002. PARTIA POLITIKE B



Raport i zgjedhjeve komunale 2009

Raporti është i bazuar në formularët e vëzhguesve të Demokracisë në Veprim gjatë fushatës parazgjedhore, ditës së zgjedhjeve më 15 nëntor dhe 13 dhjetor 2009, si dhe në hulumtimin e opinionit publik të kryer nga Demokracia në Veprim në dhjetor 2009.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	5
Konteksti politik	7
Kuadri ligjor dhe sistemi zgjedhor	8
<i>Sistemi zgjedhor</i>	8
<i>Votimet me kusht</i>	9
<i>Procedura e votimit</i>	10
Organet e administrimit të zgjedhjeve	10
<i>Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ)</i>	10
<i>Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP)</i>	12
Listat e votuesve	12
Fushata zgjedhore	12
Përgatitja e vendvotimeve	14
<i>KVV-të dhe pjesëmarrja e femrave</i>	17
Procesi i votimit	19
Ambienti i votimit	22
Procesi i numërimit të votive	23
<i>Mbyllja e vendvotimeve</i>	23
<i>Numërimi</i>	24
Përfundimet e ditës së zgjedhjeve dhe balotazhit	27
Rivotimet në komunat e Prizrenit dhe Lipjanit	29
Analiza e trendeve	30
<i>Pjesëmarrja në votime</i>	30
Analiza e mos-daljes në Zgjedhje	30
Perceptimet dhe mendimet rreth Zgjedhjeve	34
Rekomandime	37
Aneks 1.....	39
Aneks 2	40

PËRMBLEDHJE

Në aspektin e organizimit dhe mbikëqyrjes së zgjedhjeve, zgjedhjet lokale për Këshilltarë të Asambleve Komunale dhe për Kryetar Komune të vitit 2009 janë zgjedhjet e para ku institucionet kosovare, përkatësisht, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ka mbajtur përgjegjësinë e plotë për organizim dhe administrim.

Ligjet kryesore mbi zgjedhjet janë Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të cilat janë miratuar në qershor 2008 bazuar në predispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Kosovën të përgatitur nga i dërguari special i OKB-së, presidenti Ahtisaari.

Sipas legjislacionit në fuqi, kryetarët e komunave dhe kuvendet komunale kanë mandat katër vjeçar. Votuesit për zgjedhjet komunale votojnë me dy fletëvotime, një për kryetar të komunës dhe një për kuvendin komunal. Nëse në votimet e para asnjëri kandidat për kryetar komune nuk merr më shumë se 50% të votave atëherë organizohet balotazhi ndërmjet dy kandidatëve të cilët kanë pasur më së shumti vota. Balotazhi për kryetarët e komunave organizohet katër javë pas raundit të parë.

Votimi me kusht është një praktikë që shpesh përdoret në mjediset pas konflikteve për t'iu dhënë votuesve mundësinë të votojnë edhe pse ai/ajo nuk është në listën e votuesve ku ai/ajo pretendon se ka të drejtë të votoj. Votimi me kusht ka shumë mangësi dhe zakonisht vonon shpalljen e rezultateve të numërimit dhe paraqet një rrezik potencial për uljen e besimit në tërë procesin.

Zgjedhjet lokale për Asamblenë Komunale dhe për Kryetar Komunash u organizuan nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) i cili përkrahet nga Sekretariati (SKQZ) dhe ka 36 Komisione Komunale Zgjedhore

(KKZ) që zbatojnë vendimet e KQZ-së dhe janë përgjegjës për rregullimet administrative dhe logjistike të nevojshme për zgjedhje. Në nivelin e fundit vijnë Këshillat e Vend Votimeve (KVV) ku në zgjedhjet e 15 nëntorit ishin 2256 KVV.

Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për zgjedhjet e 2009 ka qenë 1.563.741. Edhe pse KQZ-ja ka bërë një punë të mirë për pastrimin e listave të votuesve ky problem ende është mjaft i pranishëm. Procedurat ligjore shumë të ndërlikuara dhe të gjata për shtimin ose fshirjen e të dhënave në listat e votuesve mbesin një sfidë.

Në anën tjetër, në shumë vendvotime janë evidentuar rastet kur votuesit nuk kanë arritur të gjejnë emrat e tyre në listat e votuesve. Sipas vëzhguesve të DV në 36% të vendvotimeve kjo ka ndodhur shpesh, në 40 % ka ndodhur pak, dhe në vetëm 14% të vendvotimeve rrallë.

Periodha para zgjedhore është shënuar me fushatë dinamike dhe aktive të kandidatëve dhe partive politike, duke shkuar nga tubimet e mëdha në zonat urbane deri te tubimet më pak formale dhe diskutimeve me njerëz në rrugë, restorante, dhe vende ku qytetarët mblidhen.

Sipas koalicionit të OJQ-ve kosovare "Demokracia në Veprim", çështjet më brengosëse të fushatës, kanë qenë përdorimi i fëmijëve në aktivitetet parazgjedhore të partive politike, nga të gjitha partitë e mëdha dhe përdorimi i veturave publike nga zyrtarë të ndryshëm për qëllime partiake.

Përkundër faktit që u përmbushën shumica e standardeve universale të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të barabarta, dita e zgjedhjeve në Kosovë u karakterizua me një varg shkeljesh, ku sipas të dhënave, kryesisht kanë qenë të natyrës së njëjtë në shumicën e vendvotimeve, përveç disa qendrave ku shkeljet ishin më të rënda. Sipas të dhënave të mbledhura nga "Demokracia në Veprim" parregullsi gjatë ditës

së zgjedhjeve ka pasur në 126 vendvotime ose në 5.6% të totalit të vendvotimeve.

Sipas vëzhguesve të Demokracisë në Veprim në ditën e zgjedhjeve më 15 nëntor 2009 përgatitjet në shumicën (91.5%) e vendvotimeve kanë filluar në kohën e duhur, pra nga ora 6:00 deri në orën 7:00. Vetëm në 8.5% të vendvotimeve përgatitjet kanë filluar me vonësë, pas orës 7:00.

Në aspektin procedural të përgatitjes së vendvotimeve, problemi kryesor i raportuar nga vëzhguesit ka qenë sigurimi i qasjes fizike në vendvotim për persona me aftësi të kufizuara, kjo mangësi është raportuar nga 25 përqindëshi i vendvotimeve.

Sipas hulumtimit të opinionit të mbajtur pas zgjedhjeve, të pyetur se sa janë të kënaqur me fushatën e informimit të votuesve të kryer nga KQZ vetëm rreth 18% të respondentëve kanë qenë shumë të kënaqur, ndërsa 15.5% aspak të kënaqur.

Në përgjithësi hulumtimi i opinionit i zhvilluar nga Demokracia në Veprim ka treguar që qytetarët besojnë që zgjedhjet kanë qenë të lira dhe demokratike. Diku rreth 78% e qytetarëve besojnë që zgjedhjet kanë qenë plotësisht të lira dhe demokratike apo deri diku të lira dhe demokratike. Në anën tjetër diku rreth 11% të qytetarëve kanë deklaruar që zgjedhjet nuk kanë qenë të lira dhe të drejta.

Gjersa shkelja e rregullave dhe procedurave të votimit nga ana e komisionarëve ka qenë relativisht e rrallë, shkelja e rregullave nga ana e vetë votuesve ka qenë shumë më e shpeshtë dhe në shumë raste komisionarët nuk kanë parandaluar dhe kontrolluar këto shkelje. Kryesuesit e KVV-ve kanë qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e votimit në vendvotimin dhe si të tillë mbajnë përgjegjësi për shkeljet e bëra nga votuesit

- Nga të dhënat e vëzhguesve, rastet e votimit familjar, pra votimet kur në kabinë kanë hyrë më

tepër se një person kanë ndodhur në 70% të vendvotimeve.

- Në shumë vendvotime (26%) ka pasur raste kur persona të paautorizuar kanë ndihmuar më tepër se një person me aftësi të kufizuara apo analfabet.
- Ndërsa në 6% të vendvotimeve janë evidentuar raste të votimit të hapur jashtë kabinave për votim.

Edhe pse në zgjedhjet lokale votuesit është dashur të votojnë për kryetar komune dhe për këshilltarët e kuvendeve komunale, ku kanë pasur mundësi që së bashku me partinë të zgjedhin edhe nga një kandidatë nga lista e partisë, ky proces i votimit nuk ju ka marrë shumë kohë. Koha mesatare e raportuar për votim ka qenë 5 minuta e 23 sekonda.

Ambienti dhe atmosfera në ditën e votimeve ka qenë relativisht e qetë dhe pa incidente. Vetëm 2.5% të vëzhguesve kanë evidentuar që në vendvotime ambienti nuk ka qenë i qetë, ndërsa në 92% të vendvotimeve është raportuar ambient i qetë.

Shumica e vëzhguesve (83%) kanë evidentuar që nuk ka pasur propagandë politike brenda vendvotimit, 12% kanë raportuar që ka pasur "pak propagandë" dhe më pak se 1% kanë raportuar "shumë propagandë".

Prezenca e personave të paautorizuar është raportuar në rreth 4% të vendvotimeve. Prezenca e personave të paautorizuar është vërejtur më së shumti në Skenderaj në 12% të vendvotimeve, në Podujevë në 11% të vendvotimeve dhe në Kamenicë në 9% të vendvotimeve.

Në hulumtimin e opinionit të kryer pas zgjedhjeve të pyetur për kënaqshmërinë e tyre me aspekte të ndryshme të përgatitjeve dhe informimit për zgjedhjet, qytetarët kanë qenë më të kënaqur me procesin e regjistrimit të votuesve (79%), pastaj me in-

formimin mbi atë se ku dhe kur do të votohet (79%), përshtatshmëria e objekteve për votim ka qenë e pëlqyer nga 78% të respondentëve, gjersa kompetencën e komisionarëve e kanë pëlqyer 70% të qytetarëve të anketuar.

Në shumicën e vendvotimeve votimi përfundoi mes orës 19:00-20:00, Vetëm në 17 vendvotimeve procesi ka përfunduar pas orës 20:00.

Sa i përket numërimit, problemi që është vërejtur në më shumë vendvotime, kanë qenë fletëvotimet e prishura dhe të refuzuara që nuk u numëruan dhe nuk u regjistruan fare.

Në përgjithësi vlerësimi i vëzhguesve ka qenë që numërimi ka rrjedhur normalisht por është me rëndësi të theksohet se rreth 5% kanë vërejtur që ka pasur disa parregullsi dhe rreth 1% që ka pasur parregullsi serioze që kanë mundur të ndikojnë në rezultate.

Që nga zgjedhjet e vitit 2000 ku pjesëmarrja në votime ka qenë 79% është vërejtur një rënie konstante dhe drastike në numrin e qytetarëve me të drejtë vote e që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje. Ky trend është ndalur në zgjedhjet e fundit me ç'rast kemi një rritje pozitive në krahasim me vitin 2007 ku përafërsisht pjesëmarrja është ngritur për 3% dhe tani është në 43.2%.

Sipas hulumtimit të opinionit arsyeja kryesore që kanë dhënë qytetarët për mos-dalje në zgjedhje me 15 nëntor, ka qenë që nuk janë të interesuar për zgjedhje dhe për politikë. Pos kësaj arsyeje, diku rreth 21% kanë raportuar që nuk kanë mundur të marrin pjesë në zgjedhje për arsye personale si sëmundje, udhëtim, shkak që nuk banojnë në vendin e regjistruar, etj. Në aspektin e arsyesimit që votuesi nuk sheh perspektivë tek politika momentale diku rreth 16% kanë thënë që për ta, të gjitha partitë duken të njëjta dhe diku rreth 6% beson se vota e tyre nuk do të sjell ndryshime. Arsyen e mos-

regjistrimit për të votuar e kanë dhënë diku rreth 7.5% të respondentëve, përderisa largësia nga qendra e votimit ka qenë arsyeja e 2% të të anketuarve.

Sipas hulumtimit trendi i daljes në votime lidhet me faktorët demografik si edukimi, që do të thotë se me rritjen e edukimit, kemi rritje të daljes në votime, edhe pse mund të theksohet që ka disa devijime që duhet të qartësohen.

Komuna me pjesëmarrje më të lartë në votime ishte Mamusha me 65% të votuesve të regjistruar që kanë përdorur të drejtën e tyre qytetare, pasojnë Skenderaj me më pak se 63%, Drenasi me rreth 62%.

Në aspektin e trendit, në krahasim me zgjedhjet e vitit 2007 në shumicën e komunave ka pasur një trend të rritjes së pjesëmarrjes në votime. Në 26 komuna pjesëmarrja në votime është rritur.

KONTEKSTI POLITIK

Pas shpalljes së pavarësisë me 17 shkurt 2008, Kosova ka miratuar Kushtetutën dhe ligjet që përcaktojnë sistemin zgjedhor dhe mënyrën e mbajtjes së zgjedhjeve. Kushtetuta i përmbahet rekomandimeve dhe obligimeve të parapara në Propozimin Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Kosovën të përgatitur nga i dërguari special i OKB-së, presidenti Ahtisaari. Në këtë aspekt, Kushtetuta e Kosovës thekson të drejtat dhe liritë e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë. Edhe pse Kosova nuk është nënshkruar i asnjë traktati për të drejtat e njeriut, sipas nenit 22 të Kushtetutës ajo obligohet t'i jep prioritet para ligjeve të Kosovës disave nga traktatet kryesore ndërkombëtare siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe për standardet zgjedhore, Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike.

Në aspektin e organizimit dhe mbikëqyrjes së zgjed-

hjeve, zgjedhjet lokale për Kuvende Komunale dhe për Kryetar Komune të vitit 2009, janë zgjedhjet e para ku institucionet Kosovare mbajnë përgjegjësinë e plotë për organizim dhe administrim. Gjegjësisht këto janë zgjedhjet e para për të cilat Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) është tërësisht përgjegjës për përgatitjen e mbajtjen e zgjedhjeve. KQZ gjithashtu është ndihmuar nga OSBE dhe organizata tjera ndërkombëtare.

KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashihet që të administrohen zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes lokale demokratike.

Ligjet kryesore mbi zgjedhjet janë Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji mbi zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të miratuara në qershor 2008, bazuar në predispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Kosovë të përgatitur nga i dërguari special i OKB-së, presidenti Ahtisaari. Aktet e tjera të rëndësishme ligjore për zgjedhjet lokale të 2009 janë Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale dhe Ligji mbi Kufijtë Administrativ Komunal.

Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme krijon hapësirë dhe ia jep të drejtën KQZ-së që më tutje të rregullojë shumë aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore. Për zgjedhjet lokale të vitit 2009, KQZ-ja ka nxjerrë katërmbëdhjetë Rregulla të ndryshme Zgjedhore.

Pra të drejtat dhe liritë themelore për zgjedhje demokratike sipas standardeve ndërkombëtare janë

të garantuara nga Kushtetuta e Kosovës, ligjet kryesore mbi zgjedhjet dhe Rregullat e KQZ-së që përshkruajnë aspektet e ndryshme të një procesi zgjedhor. Përcaktimin e datës së zgjedhjeve dhe shpalljen e zgjedhjeve e bën Presidenti i Kosovës.

Sistemi zgjedhor

Sipas ligjeve në fuqi kryetarët e komunave dhe kuvendet komunale kanë mandat katër vjeçar¹. Numri i anëtarëve të kuvendeve komunale determinohet në bazë të numrit të banorëve të komunës dhe ndryshon ku në komunat më të vogla me më pak se 10,000 banorë është paraparë që asambleja komunale ti ketë 15 anëtarë gjersa në Prishtinë, si komuna më e madhe, numri i deputetëve është 51². Votuesit për zgjedhjet komunale votojnë me dy fletëvotime një për kryetar të komunës dhe një për kuvendin komunal.

Sipas ligjeve nëse në votimet e para asnjëri kandidat për kryetar komune nuk merr më shumë se 50% të votave atëherë organizohet balotazhi ndërmjet dy kandidatëve të cilët kanë pasur më së shumti vota. Balotazhi për kryetarët e komunave organizohet katër javë pas rëndit të parë.

Anëtarët e kuvendeve komunale zgjidhen sipas sistemit proporcional në kombinim me votim preferencial për kandidatët e partive apo kandidat të pavarur. Votuesi shënon votën e tij në dy lista që gjenden në të njëjtën fletëvotim. Së pari duhet të zgjedh partinë të cilën e preferon në listën e parë dhe pastaj e shënon numrin e kandidatit nga ajo parti në listën e dytë. Vota për parti në listën e parë, pa përcaktuar edhe kandidatin specifik, njehsohet si votë për kandidatin e parë të asaj partie prandaj në listën e dytë vota mund të jepet duke filluar vetëm nga kandidati i dytë.

Votimi për kandidat është opsional, nëse votuesi e pëlqen kandidatin e parë apo nuk ka preferencë

¹ Ligji për Qeverisjen Lokale, Neni 37.1.

² Ligji për Qeverisjen Lokale, Neni 37.1.

ndërmjet kandidatëve në listë atëherë mund të mos shënojnë në listën e dytë. Por nëse e preferon një kandidat nga lista atëherë pos votimit të partisë duhet të votojë edhe numrin e kandidatit. Nëse votuesi gabon në listën e parë për parti atëherë fletëvotimi i tij/saj konsiderohet si e pavlefshme. Në anën tjetër vota në listën për kandidatë është opsionale prandaj gabimet apo mosshënimi i preferencës në këtë listë nuk e bën fletëvotimin si të pavlefshëm.

Sipas ligjeve, së paku 30% e kandidatëve të zgjedhur duhet të janë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Prandaj partitë në shumë raste shënojnë çdo të tretin kandidatë të gjinisë tjetër. Mirëpo, pasi që më nuk janë listat e mbyllura, ky mekanizëm si i vetëm nuk mund të realizojë kuotën gjinore prej 30%, prandaj është par e nevojshme që të sigurohet e njëjta në një mënyrë tjetër. Në përfundim të numërimit të votave të kandidatëve, kandidatët e gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të përbëjnë së paku 30% të listës së riradhitur në bazë të votave. Nëse p.sh. tre kandidatët në krye të listës janë të një gjinie, atëherë kandidati i tretë largohet në favor të kandidatit të gjinisë tjetër që ka numrin më të madh të votave të fituara. Ky proces vazhdon deri sa kandidatët e secilës gjini kanë së paku 30% të vendeve të fituara.

Nevoja për vazhdimin e votimit të përgjithësuar dhe standardizuar me kusht duhet të diskutohet. Për shembull, procedurat e ngjashme me nevojat e veçanta për votim mund të zbatohen për rastet e mbetura specifike siç janë Personat e Zhvendosur.

Sikurse parashihet në Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja ka për detyrë të menaxhojë shumicën e aspekteve të regjistrimit të partive politike dhe deklarimit financiar si dhe regjistrimin e subjektit politik dhe kandidatit. Shumica e rregullave zgjedhore të përpiluara nga KQZ-ja kanë të bëjnë me

entitetet dhe kandidatët politik. Për zbatimin e procedurave afatgjate, stabile dhe transparente, ligje të veçanta lidhur me regjistrimin dhe operimin e partive, entiteve, dhe kandidatëve politik duhet të merren parasysh.

Gjatë javëve të kaluara para zgjedhjeve, dokumentet identifikuese të votuesve ishin temë e gjerë e diskutimit publik. Ligji parasheh që votimet mund të bëhen edhe me pasaportën valide dhe letërnjoftimin valid duke mos specifikuar origjinën e dokumenteve. Sipas ENEMO-s³ shqetësimet janë ngritur veçanërisht nga komunitetet pakicë rreth përdorimit të identifikimit valid nga jashtë Kosovës. Në kontekstin e Kosovës është posaçërisht e rëndësishme që votuesit të kenë informata të qarta dhe të kuptueshme lidhur me dokumentin identifikues të pranueshëm dhe valid për zgjedhje. Votimi jashtë vendit për zgjedhjet lokale nuk është një praktikë e rëndomtë. Për shkak të shumë sfidave teknike dhe logjistike kjo procedurë ka shpenzuar energjinë e administrimit zgjedhor.

Votimet me kusht

Janë disa çështje në legjislacionin dhe rregullat ekzistuese që duhet të adresohen. Neni 95 i Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme i jep votuesit një mundësi të votojë me kusht nëse nuk gjenden në listën e votuesve. Votimi me kusht është një zgjidhje që shpesh përdoret në mjediset pas konflikteve për t'iu dhënë votuesve mundësinë të votojnë edhe pse ai/a jo nuk është në listën e votuesve ku ai/a pretendon se ka të drejtë të votojë. Votimi me kusht ka shumë mangësi dhe zakonisht vonon shpalljen e rezultateve të numërimit dhe paraqet një rrezik potencial për uljen e besimit në tërë procesin. Gjithashtu ka shpenzime shtesë pasi që duhet të bëhen kontrollet e repta të votimit dhe numërimit.⁴

³ ENEMO, International Observation Mission to Kosovo Municipal Elections 2009. Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Preliminare. Prishtinë, nëntor 2009.

⁴ ENEMO, International Observation Mission to Kosovo Municipal Elections 2009. Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Preliminare. Prishtinë, nëntor 2009.

Procedura e votimit

Pasi që votuesi e gjen vendvotimin, në hyrje votuesit i kontrollohet gishti për shenja të ngjyrës së padukshme. Pastaj, njëri nga anëtarët e ekipit të vendvotimit e vërteton identitetin e votuesit dhe kontrollon emrin e votuesit në listën e votuesve. Pasi që votuesi nënshkruan pranë emrit të vet i ipen dy fletëvotime: një për zgjedhjet për kuvendet komunale si dhe një për kryetar të komunës.

Pas përzgjedhjes së subjektit politik, votuesi mund të votoj një kandidat të subjektit të cilin e ka përzgjedhur. Fletëvotimi nuk i ka emrat e kandidatëve brenda, por vetëm numrat nga 1 deri në 52 – secili numër korrespondon me një kandidat të subjektit të zgjedhur. Emrat e kandidatëve gjenden në një libërth të cilën duhet ta ketë secila kabinë e votimit ku votuesi ka mundur të kontrollonte emrat para se të shënonte numrat në fletëvotim.

ORGANET E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ)

Zgjedhjet lokale për Asamble Komunale dhe për kryetar komune 2009 janë zgjedhjet e para për të cilat Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) është përgjegjës për përgatitjen e mbajtjen e zgjedhjeve. KQZ-ja përkrahet nga Sekretariati (SKQZ) dhe janë 36 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ) që zbatojnë vendimet e KQZ-së dhe janë përgjegjës për rregullimet administrative dhe logjistike të nevojshme për zgjedhje. Në nivelin fundit vinë Këshillat e Vendvotimeve (KVV) ku në zgjedhjet 15 nëntorit ishin 2256 KVV⁵.

KQZ-ja përbëhet nga 11 anëtarë me një ulëse të emëruar nga Kryetari i Kosovës për gjyqtarët e Gjykatës Supreme. Në përgjithësi, KQZ-ja ka treguar

një nivel të lartë të angazhimit gjatë përgatitjes së zgjedhjeve. Rekrutimi dhe trajnimi i stafit administrues dhe vendvotues në zonat jo serbe si dhe prokurimi i materialit në përgjithësi janë bërë në mënyrë të duhur. Shpërndarja e materialit të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm zgjedhor nëpër komunë është realizuar mirë por nuk janë evituar të gjitha problemet në këtë aspekt dhe janë vërejtur probleme nëpër vendvotime të ndryshme për shkak të mungesës së materialit të nevojshëm.

Pavarësisht vonesave në përzgjedhjen e stafit dhe funksionalizimit të KQZ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i përgatiti dhe i administroi zgjedhjet me paanshmëri politike dhe në përputhshmëri me shumicën nga standardet universale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve por mangësitë sidomos në imponimin e rregullave të procesit zgjedhor dhe parandalimin e shkeljes së tyre janë vërejtur në shumë vendvotime. Pjesërisht për shkak të problemeve me parregullsi në procesit zgjedhor dhe pjesërisht për shkak të rezultatit të ngushtë mes kandidatëve për kryetar komune zgjedhjet e raundit të dytë janë përsëritur në dy komuna, Gjilan dhe Prizren.

Ndër mangësitë kryesore të cilën e kanë përcjellë punën e KQZ-së gjatë përgatitje zgjedhore kanë qenë vonesa e informimit të qytetarëve në lidhje me ndërrimet e vendvotimeve, vonesat në edukimin e qytetarëve për të votuar, trajnimi jo adekuat i komisionarëve zgjedhor si dhe vonesat në përgatitjet për funksionalizimin e Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR).

Të gjitha këto mangësi kanë reflektuar gjatë ditës së zgjedhjeve dhe pastaj në dhënien e rezultateve përfundimtare për raundin e parë të zgjedhjeve. Si rezultat i krijimit të qendrave të reja të votimit dhe i mos-njoftimit me kohë të qytetarëve në lidhje me

⁵ Demokracia në Veprim. Deklaratë për procesin e raundit të parë të zgjedhjeve të mbajtura me 15 nëntor. Nëntor 2009, Prishtinë

këto ndërrime, gjatë ditës së zgjedhjeve ka pasur një numër të madh të qytetarëve të cilët është dashur të votojnë me kusht, ose në rastin më të keq edhe të mos votojnë fare për shkak të hezitimit të tyre për të votuar me kusht, për shkak të mosbesimit se vota e tyre do të numërohet drejt⁶.

As pas alarmimeve nga vëzhguesit e pavarur por dhe nga vëzhguesit partiak KQZ nuk ka ndërmarrë hapa konkret dhe adekuat për të ndërhyrë në përmirësimin e procesit gjatë ditës së zgjedhjeve. KQZ nuk ka arritur që të krijojë ekipe mobile ose ekipe të inspektoratit të cilët do të inspektonin Qendrat e Votimit gjatë procesit zgjedhor në mënyrë që të ushtronin një mbikëqyrje dhe të siguronin një proces më adekuat.

Njëri nga problemet kryesore është se KQZ-ja nuk ka mundur të dalë me rezultate përfundimtare për raundin e parë edhe për disa javë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve. Vonesa në shpalljen e rezultateve ka qenë më e theksuar në balotazhin për kryetar komune, ku në rastin e Gjilanit kjo ka zgjatur më shumë se një muaj. Këto vonesa kryesisht kanë ndodhur për shkak të vonesave të cilat janë bërë nga QNR, por këtu një pjesë të fajit e bartë edhe Këshilli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) i cili akoma nuk ka marrë vendime të shpejta për të gjitha ankesat e parashtruara para këtij organi, e që automatikisht ka bllokuar certifikimin e rezultateve të raundit të parë. Poashtu ka mendime që një pjesë të fajit e bartë edhe KQZ-ja për shkak të përzgjedhjes së KKZ-ve. Gjithashtu, mosmarrja e veprimeve kundër individëve që kanë bërë shkelje tregon se shkeljet me gjasë do të tolerohen edhe në të ardhmen. Përkundër faktit që është pritur që në komunat në veri të Kosovës nuk do të ketë pjesëmarrje të qytetarëve në votim, Demokracia në Veprim konsideron se në ato vende nuk janë ofruar kushte të mjaftueshme për të ushtruar të drejtën e votimit ku

do të sigurohej fshehtësia e votës. Duke konsideruar situatën në veri të Kosovës, KQZ-ja nuk mund të konsiderohet si organ i vetëm përgjegjës në këtë aspekt ngase institucionet qeverisëse dhe të sigurisë (si Kosovare ashtu edhe ato ndërkombëtare) është dashur të ndihmojnë KQZ-në dhe të mundësojnë krijimin e kushteve më të mira për votim.

Ka qenë e dukshme se KQZ-ja ende varet nga ndihma e jashtme. Disa aktivitete të rëndësishme janë organizuar nga IFES, siç janë Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve, vendosja e vendvotimeve mobile në tri komunat veriore serbe të Kosovës dhe fushatat për informimin e votuesve.

Gjithashtu, OSBE-ja ka qenë shumë e dukshme duke dhënë këshilla teknike në nivel qendror dhe lokal. Gjatë tërë periudhës zgjedhore KQZ-ja ka bashkëpunuar me grupe të ndryshme të interesit për ngritjen e rolit të tyre si administrues të zgjedhjeve dhe kanë mbajtur kanale të vazhdueshme dhe të hapura të komunikimit. Mirëpo, dukshmëria e ulët e fushatës për edukimin e votuesve, e udhëhequr nga KQZ-ja, mbetet një fakt. Një shqetësim tjetër është se votuesit (veçanërisht në zonat me popullatë pakicë), nuk janë informuar me kohë dhe në mënyrë të duhur për vendet që do të votojnë, ose për rregullimet alternative që janë bërë.

Në ditën e zgjedhjeve KQZ-ja ka mbajtur një varg të konferencave për shtyp për të informuar opinionin për rrjedhën e zgjedhjeve.

Caktimi i anëtarëve të KKZ-ve, stafi i vendvotimeve dhe përzgjedhja e vendvotimeve në komunitetet serbe të Kosovës ka hasur në shumë vështirësi. Stafi që ishte caktuar më herët kishin dhënë dorëheqje dhe ndërtesat publike nuk mund të përdorehin si vendvotime. Në komunat veriore të Zveçanit dhe Zubin Potokut vetëm një vendvotim mobil ishte

⁶ Demokracia në Veprim. Deklaratë për procesin e raundit të parë të zgjedhjeve të mbajtura me 15 nëntor. Nëntor 2009, Prishtinë

hapur. Për shkaqe sigurie asnjë vendvotim nuk është hapur në komunën e Leposaviqit.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP)

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), si organ i përhershëm dhe i pavarur ka pasur vështirësi të shumta në funksionalizimin e vetë. Si rezultat i mos-alokimit me kohë të buxhetit për këtë institucion, KZAP është ballafaquar me një mori vështirësish që kanë shkaktuar probleme në funksionalizimin e tij, duke filluar që nga mungesa e stafit administrativ e deri tek mungesa e hapësirës së nevojshme për të ushtruar funksionet dhe detyrat e veta në mënyrë të duhur. KZAP-i edhe dhjetë ditë para zgjedhjeve nuk ka qenë plotësisht funksional. Sipas ligjit për zgjedhjet anëtarët e emëruar të KZAP-it prej 60 ditësh para ditës së zgjedhjeve e deri në certifikim të rezultateve duhet ti japin përparësi obligimeve të tyre si anëtar të KZAP-it kjo nuk ka ndodhur gjatë gjithë procesit zgjedhor. Për më tepër edhe Sekretariati nuk ka qenë funksional dhjetë ditë para zgjedhjeve.

Mungesa e transparencës së KZAP-it ka qenë një problem permanent. KZAP-i po ashtu nuk ka pasur hapësirë të mjaftueshme për të ushtruar funksionin e vetë, sekretariati i KZAP-it nuk ka pasur personelin e duhur, përderisa vendimet të cilat i ka marr KZAP-i, janë publikuar me vonesë.

Të gjitha këto mangësi të cilat e kanë përcjell punën e KZAP-it, kanë reflektuar në zvarritje të marrjes së vendimeve për ankesat e parashtruara tek ky institucion e sidomos për ankesat që kanë të bëjnë me ditën e votimit, e që drejtpërsëdrejti po ndikon në shpalljen e rezultateve finale nga ana e KQZ-së.

Në përfundim mendimi i gjerë është që vonesat në certifikimin e rezultateve kanë qenë si pasojë e vonesave të KZAP-it për të marrë vendime të shpejta për të gjitha ankesat e parashtruara para këtij organi, e që automatikisht ka bllokuar certifikimin e rezultateve të raundi të parë por edhe të balotazhit.

LISTAT E VOTUESVE

Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për zgjedhjet e 2009 ka qenë 1.563.741. Edhe pse KQZ-ja ka bërë një punë të mirë për pastrimin e listave të votuesve, ky problem ende është i pranishëm. Procedurat ligjore shumë të ndërlikuara dhe të gjata për shtimin ose fshirjen e të dhënave në listat e votuesve mbetet një sfidë.

Lista e votuesve në Kosovë shumë është debatuar dhe kritikuar për përmbajtjen e emrave që i takojnë të vdekurve ose personave që për ndonjë arsye janë futur gabimisht. Nuk ekziston një regjistrim aktiv i votuesve, ndërsa lista e votuesve është një fragment i regjistrimit civil të Kosovës që është pjesë e strukturës së administratës civile në secilën komunë.

Por në anën tjetër, në shumë vendvotime janë evidentuar rastet kur votuesit nuk kanë arritur të gjejnë emrat e tyre në listat e votuesve. Sipas vëzhguesve të zgjedhjeve në 36% të vendvotimeve kjo ka ndodhur shpesh, në 40 % ka ndodhur pak, dhe në vetëm 14% të vendvotimeve rrallë. Më së shumti probleme me mungesën e emrave në listën e votuesve është vërejtur në komunën e Junikut, Kamenicës dhe Klinës.

FUSHATA ZGJEDHORE

Periodha para zgjedhore është shënuar me fushatë dinamike dhe aktive të kandidatëve dhe partive politike. Nga tubimet e mëdha në zonat urbane deri te tubimet më pak formale dhe diskutimet me njerëz në rrugë, restorante, dhe vende ku qytetarët mblidhen.

Periodha zyrtare e fushatës filloi me 15 tetor. Fushata elektorale kryesisht ka qenë e qetë, përkundër disa incidenteve të dhunshme. Udhëheqësit e mëdhenj

politik kanë udhëtuar në masë të madhe, duke mbajtur tubime në tërë vendin. Zyret e fushatave lokale ishin hapur në shumicën e regjioneve. Fushata rrallë është njollësuar me gjuhë të vrazhdë kundër rivalëve.

Sipas koalicionit të OJQ-ve kosovare "Demokracia në Veprim"⁷, çështjet më brengosëse gjatë fushatës kanë qenë përdorimi i fëmijëve në aktivitetet e fushatave të partive politike, nga të gjitha partitë e mëdha dhe përdorimi i veturave publike nga zyrtarë të ndryshëm për qëllime partiake.

Gjatë fushatës janë vërejtur raste kur zyrtarë komunalë që nuk kanë dhënë dorëheqje nga postet e tyre marrin pjesë në fushatë si kandidatë politikë⁸. Po ashtu janë vërejtur që disa zyrtarë komunalë marrin pjesë në tubime partiake gjatë orarit të punës. Vërejtje tjetër që është paraqitur, ka qenë edhe edhe shfrytëzimi i ndërtesave publike për qëllime partiake. Shfrytëzimi i shkollave për takime (në Prishtinë, Rahovec, Deçan), vendosja e posterëve në shkolla (në Prishtinë, Klinë), apo vendosjes së posterëve në hapësirat e komunës (në Deçan) objekte tjera publike siç janë tabelat e komunikacionit (në Klinë).

Po ashtu ka pasur ankesa nga partitë politike lidhur me sjelljen e rivalëve të tyre. Rasti më i rëndë ka qenë në Skenderaj ku LDK është ankuar për thyerjen e xhamave të selisë dhe grisjen e posterëve. Ka pasur ankesa të shumta për vendosjen e posterëve dhe pllakateve në vendet publike, për heqjen e posterëve, për përdorimin e fëmijëve në posterë partiak të kandidatit për kryetar komune për grisje të posterëve, dëmtim të shtizave të flamujve. Në disa instanca ka pasur grindje dhe kacafytje mes simpantizantëve të partive por pa pasoja të rënda.

Gjatë fushatës zgjedhore komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ-të), kanë vijuar punën pa probleme në shumicën e komunave, por është vërejtur një

mungesë e profesionalizmit të stafit të KKZ-ve në disa komuna. Në Prizren dhe Skenderaj, KKZ-të nuk kanë mbajtur takime fare. Në përgjithësi është hasur në mungesë të materialit informues lidhur me mënyrën e votimit. Në Graçanicë nuk ka pasur informata fare për vendvotimet një kohë të gjatë. Po ashtu, akreditimi i vëzhguesve nuk është bërë me kohë nga KQZ, dhe kjo ka shpër në vështirësi për kryerjen e punëve të tyre⁹.

Një çështje tjetër që është theksuar ka qenë pjesëmarrja shumë e vogël e grave në aktivitete politike si dhe në KKZ.

Kah fundi i fushatës, kandidatët kanë organizuar takime të mëdha me koncerte, që tërhiqnin popullatën e re. Një aspekt negativ është se shumë të mitur kanë qenë aktivisht të përfshirë në fushatat e kandidatëve dhe partive, si aktivistë ose përkrahës të partive politike. Është vërejtur se fushata ka qenë më e dukshme dhe më e shtrenjtë në kryeqytet dhe në televizioni publik, shumë më tepër se në nivel lokal dhe në aktivitetet derë më derë.

Incidenti më i rëndë ka qenë kur autokolona e Kryeministrit Thaçi është sulmuar me gurë në mbrëmjen e 11 nëntorit, me rastin e largimit nga qyteti i Deçanit pas një tubimi të organizuar aty. Përveç këtij shembulli, ka pasur edhe disa ngjarje të dhunshme, motivet e të cilave nuk janë krejtësisht të qarta.

Pritet që institucionet e duhura të veprojnë në mënyrë efikase për adresimin e këtyre rasteve. Bazuar në fushatat shumë aktive dhe të dukshme përfundimi është se votuesit kishin zgjedhje si në përmbajtje ashtu edhe në informacion, dhe se kandidatët kanë shpalosur programe të detajuara me shpresën e fitimit të zgjedhjeve.

⁷ Demokracia në Veprim. Raporti për javën e parë, Tetor, 2009

⁸ Demokracia në Veprim. Raporti për javën e tretë, Nëntor, 2009

⁹ Demokracia në Veprim. Raporti për javën e parë, Tetor, 2009

PËRGATITJA E VENDVOTIMEVE

Sipas vëzhguesve të Demokracisë në Veprim në ditën e zgjedhjeve më 15 nëntor 2009 përgatitjet në shumicën (91.5%) e vendvotimeve kanë filluar në kohën e duhur, pra nga ora 6:00 deri në orën 7:00. Në 8.5% të vendvotimeve përgatitjet kanë filluar me vonesë, pas orës 7:00. Ndërsa në një vendvotim në Klinë përgatitjet nuk kanë filluar fare dhe vendvotimi nuk është hapur fare. Në aspektin e vonesës së përgatitjeve, më së shumti vonesa janë evidentuar në Prizren në 37 vendvotime apo në 18.7% të vendvotimeve, në Rahovec në 10 vendvotime (16.1%), pas-taj në, Gjakovë dhe Prishtinë (shih tabelën 1).

Vonesat në përgatitje kanë rezultuar në vonesa në hapjen e vendvotimeve. Rreth 27,3% të vendvotimeve janë hapur para orës 7:00, ndërsa prej orës 7:00 deri në orën 8:00 janë hapur 72.3% të vendvotimeve dhe 0.3% (apo 11) të vendvotimeve janë

hapur pas orës 8:00. Gjashtë vendvotimet e hapura pas orës 8:00 kanë qenë në Prizren dhe Prishtinë. Vonesa mesatare në hapjen e vendvotimeve ka qenë 20 minuta.

Në aspektin e përgatitjeve të vendvotimit, prezenca e materialit propagandues zgjedhor në më pak se 100 metra nga vendvotimi është raportuar në 3% të vendvotimeve.

Sa i përket materialeve të nevojshme për votime, vëzhguesit kanë raportuar që në fillim të votimeve "lista e kandidatëve" ka munguar në 14.7 % të vendvotimeve, "lista e subjekteve politike" në 13.9% të vendvotimeve, dhe në 12.7% të vendvotimeve kanë munguar "informatat se si të votohet". Më së shumti mungesa të informatave se si të votohet si dhe mungesa të listave janë evidentuar në vendvotimet në Han të Elezit, Podujevë dhe Prishtinë.

Pos materialeve të përmendura më lartë, në rreth 3% të vendvotimeve, vëzhguesit kanë raportuar mungesë të materialeve tjera të nevojshme. Këto

Komuna	Fillimi në kohën e paraparë	Vonesat		Përqindja e vendvotimeve që filluan përgatitjet me vonesë
		7:00 - 8:00	pas 8:00	
Prizren	156	36	1	19.2%
Rahovec	52	10		16.1%
Gjakovë	100	15		13.0%
Prishtinë	181	24	1	12.2%
Istog	57	7		10.9%
Drenas	49	6		10.9%
Shtime	26	3		10.3%
Obiliq	20	2		9.1%
Dragash	51	5		8.9%

Tabela 1. Komunitat ku ka pasur më së shumti vonesa në fillimin e përgatitjeve.

Kur është hapur vendvotimi?




Figura 1. Koha e hapjes së vendvotimeve.

mungesa në shumicën e rasteve janë tejkaluar më vonë por kanë shkaktuar vonesë. P.sh. bateritë për llambat me ngjyrë ultraviolete kanë munguar në disa vendvotime në Podujevë, vula ka munguar për 20 minuta në një vendvotim në Podujevë. Listat e subjekteve politike kanë munguar në Mitrovicë, Viti, Po-

dujevë, dhe Gjilan. Kapaku i një kutie ka munguar në një vendvotim në Prizren. Në shumë vendvotime nuk ka pasur libër për të verbërit. Por në shumicën e rasteve këto janë adresuar më vonë.

Në aspektin procedural të përgatitjes së vendvotimeve, problemi kryesor i raportuar nga vëzhguesit ka qenë sigurimi i qasjes fizike në vendvotim për persona me aftësi të kufizuara, kjo mangësi është raportuar nga 25 përqindëshi i vëzhguesve.

Vlen të theksohet se në 10 vendvotime (apo në më pak se 1% të vendvotimeve) nuk janë treguar kutitë e zbrazëta para se të fillojë votimi, ky problem është raportuar në tre vendvotime në Prishtinë, dy vendvotime në Junik, dhe me nga një rast është eviden-

A janë vendosur materialet në vijim në brenda dhe jashtë kabinës?




Figura 2. Prezenca e materialeve të nevojshme për votim.

A janë vendosur materialet në vijim brenda dhe jashtë vendvotimit?




Figura 3. Pajisja me materiale brenda dhe jashtë vendvotimit.

tuar në Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjiilan, Kamenicë, dhe në Prizren.

Krahasimet ndërmjet raundit të parë të zgjedhjeve të mbajtura më 15 nëntor dhe balotazhit të mbajtur më 13 dhjetor tregon se nuk ka pasur përmirësime në qasjen e personave me aftësi të kufizuara. Në çdo të tretin vendvotim ata kanë hasur në vështirësi për qasje në vendvotim. Por vlen të theksohet se qasja për persona me aftësi të kufizuara është më shumë

problem infrastrukturor i objekteve ku mbahen zgjedhjet (shkollat dhe objektet tjera publike) dhe në këtë aspekt nuk mund të trajtohet dhe të përshtaten shpejt gjatë procesit zgjedhor.

Sipas hulumtimit të opinionit të mbajtur pas zgjedhjeve, të pyetur se sa janë të kënaqur me fushatën e informimit të votuesve të kryer nga KQZ, vetëm rreth 18% të respondentëve kanë qenë shumë të kënaqur, ndërsa 15.5% aspak të kënaqur.

Çështjet	Po	Jo	Pa përgjigje
A kanë qasje fizike personat me aftësi të kufizuara?	48.0%	28.2%	23.8%
A është treguar kutia e zbrazët para se të fillojë votimi?	97.3%	0.6%	2.1%
A janë mbyllur kutitë me shirita të sigurisë?	97.2%	0.1%	2.7%
A janë regjistruar numrat serik të shiritave në librin e duhur?	93.8%	0.2%	6.0%
A janë të vendosura kabinat në mënyrë që të sigurojnë fshhtësinë e votës?	96.6%	0.2%	3.2%

Tabela 2. Përgatitja e vendvotimeve për procesin zgjedhor.

A kanë qasje fizike në vendvotim personat me aftësi të kufizuara?




Figura 4. Mundësia e qasjes fizike në vendvotime të personave me aftësi të kufizuara.

Në anën tjetër shumica e repondentëve nuk kanë hasur në probleme për të gjetur vendvotimin, rreth 75% të votuesve kanë gjetur vendvotimin e tyre shume lehtë ndërsa më pak se 4% të repondentëve e kanë pasur shumë të vështirë apo disi të vështirë për të gjetur vendvotimin.

KVV-të dhe pjesëmarrja e femrave

Numri i anëtarëve të KVV-së në vendvotime ka ndryshuar mesatarja e numrit të anëtarëve ka qenë 7.2. Më së paku anëtarë ka pasur në Komunën e Fushë Kosovës me mesatare prej 6.6 anëtarë të KVV ndërsa më së shumti në atë të më Skenderajt me një





Figura 5. Kënaqshmëria me fushatën e informimit për votime



Sa e lehtë ose e vështirë ka qenë për ju që të gjeni qendrën e juaj të votimit?

Figura6. Vështirësitë për gjetjen e qendrës së votimit.

mesatare prej 10.4 anëtarë. Numri i femrave në KVV ka qenë i ulët me mesatare prej 1.3 anëtarëve, pra mesatarisht rreth 18% e anëtarëve kanë qenë femra. Më së paku femra si anëtarë të KVV-ve ka pasur në komunën e Dragashit me vetëm rreth 3% të anëtarëve femra, ndërsa më së shumti në Prishtinë me 38% të anëtarëve femra.

Në këtë aspekt krahasuar me zgjedhjet komunale dhe qendrore të vitit 2007 numri fermave anëtare të KVV ka treguar një rrënje prej 5%, nga 23% sa ka qenë në zgjedhjet e vitit 2007 në 18% në zgjedhjet e vitit 2009.

Përbërje përafërsisht të njëjtë KVV-të kanë pasur edhe më 13 dhjetor gjatë balotazhit. Mesatarisht KVV-të kishin nga 7.1 anëtarë, nga të cilët 6 prej tyre ishin meshkuj dhe një femër.

Qyteti	Mesatarja e anëtarëve të KVV	Mesatarja e anëtarëve Femra të KVV
Dragash	7.3	0.3
Gjilan	7.8	2.1
Hani I Elezit	9.1	0.6
Kaçanik	7.0	1.0
Kamenice	7.5	1.3
Lipjan	7.1	0.7
Mitrovicë	6.9	1.6
Novo Berdo	6.7	0.8
Obiliq	7.2	1.3
Pejë	6.7	1.7
Podujevë	7.5	1.6
Prizren	6.8	1.6
Rahovec	7.1	0.4
Shtërpce	4.5	1.3
Suharekë	7.4	1.4
Vushtrri	7.0	1.7
Mesatarja	7.1	1.2

Tabela3. Përbërja e KVV-ve në Komunitat për balotazh 13 dhjetor 2009.

PROCESI I VOTIMIT

Në përgjithësi hulumtimi i opinionit i zhvilluar nga Demokracia në Veprim ka treguar që qytetarët besojnë që zgjedhjet kanë qenë të lira dhe demokratike me rreth 78%. Por brenda këtij grupi vetëm 41% besojnë që zgjedhjet kanë qenë plotësisht të lira dhe demokratike, ndërsa 37% kanë deklaruar që zgjedhjet ishin deri diku të lira dhe demokratike. Në anën tjetër diku rreth 11% të qytetarëve kanë deklaruar që zgjedhjet nuk kanë qenë të lira dhe të drejta (shih Figurën 7). Këto opinione në një masë pasqyrojnë vlerësimet dhe deklaratat e organizatave ndërkombëtare dhe ato institucioneve vendore të dhëna mbas procesit zgjedhor për mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe mungesën e incidenteve të theksuara gjatë procesit zgjedhor.

Sa të lira dhe të drejta kanë qenë zgjedhjet e 15 nëntorit 2009?



Figura 7. Mendimet rreth çështjes se sa kanë qenë të lira dhe të drejta zgjedhjet e 15 nëntorit 2009.

Raportet e vëzhguesve të Demokracisë në Veprim në përgjithësi tregojnë se nuk ka probleme me respektimin e rregullave të procesit zgjedhor në shumicën e vendvotimeve (në rreth 97%). Sipas vlerësimit të vëzhguesve në disa vendvotime këto rregulla janë respektuar rrallë, gjersa në 2% të vendvotimeve rregullat nuk janë respektuar gjithmonë. Më së shumti raportime për shkeljen e rregullave të procesit zgjedhor ka pasur nga vëzhguesit në qendrat e votimit në komunën e Skenderajt gjithsej katër, pastaj pason Juniku me raportime për shkelje nga dy vendvotime, ndërsa shkelje të procedurave me nga një vendvotim ka pasur në Prishtinë, Prizren, Suharekë, Kaçanik, Ferizaj dhe Gjakovë.

Përderisa shkelja e drejtpërdrejtë e rregullave dhe procedurave të votimit nga ana e komisionarëve ka qenë relativisht e rrallë. Në anën tjetër shkelja e rregullave nga ana e vetë votuesve ka qenë shumë më e shpeshtë. Pra në njëfarë mënyre edhe pse komisionarët kanë respektuar rregullat dhe procedurat e votimit, kur këto rregulla dhe procedura janë shkelur nga ana e votuesve ata nuk janë kujdesur ti parandalojnë ato apo të raportojnë ato në mënyrë adekuate. Pra imponimi i rregullave dhe mbikëqyrja e procesit nga ana e komisionarëve nuk ka qenë në nivel të duhur.

Për analizën e parregullsive duhet të theksohet që sipas formularëve vëzhguesit vetëm kanë shënuar a ka ndodhur parregullsia apo jo dhe nuk kanë qenë të obliguar të shënojnë numrin e rasteve. Pra në analizat në vijim, numrat reflektojnë se a është vroj-

	Gjithmonë	Kryesisht	Rrallë (vendvotime)	Pa përgjigje
A kontrollohet ngjyra e padukshme në gishtin e votuesit?	96.5	2.5	0.1 (1)	0.9
A është duke u bërë kontrollimi i duhur i dokumenteve të identifikimit?	97.0	2.1	0.2 (3)	0.9
A janë duke u nënshkruar votuesit në listën e votuesve?	97.2	1.6	0.2 (3)	1.2
A janë vulosur fletëvotimet para se të dorëzohen votuesit?	97.6	0.6	0.1 (2)	1.9
A është spërkatur ngjyra e padukshme në gishtin adekuat të votuesit?	96.6	1.3	0.2 (3)	2.2

Tabela 4. Raportimi i respektimit të rregullave të procesit zgjedhor.

Rastet e votimit të hapur jasht kabinave.

tuar ndonjë nga parregullsitë e shënuara në vendvotimin e caktuar por jo edhe numri i rasteve të parregullsisë në atë vendvotim. Në këtë aspekt nuk mund të përcaktohet nëse parregullsia ka qenë e shpeshtë apo ka ndodhur në raste të izoluar.

Në këtë aspekt, rastet e votimit familjar, kanë qenë problemi i raportuar më së shpeshti. Nga raportimet e vëzhguesve, rastet e votimit familjar, pra votimet kur në kabinë kanë hyrë më tepër se një person kanë ndodhur në 70% të vendvotimeve. Gjithashtu në shumë vendvotime (26%) ka pasur raste kur persona të paautorizuar kanë ndihmuar më tepër se një person me aftësi të kufizuara apo analfabet. Ndërsa në 6% të vendvotimeve janë evidencuar raste të votimit të hapur jashtë kabinave për votim. Po ashtu në 20% të vendvotimeve nëse fletëvotimi është dëmtuar ajo nuk është zëvendësuar pra votuesi nuk ka mundur të përfundojë votimin.




Figura 8. Rastet e votimit të hapur sipas komunave.

	Jo	Po	Pa përgjigje
A ka refuzuar ndonjë votues të spërkas gishtin?	91.8	0.8	7.4
A ka pasur raste të votimit jashtë kabinave?	85.3	6.3	8.4
A ka pasur raste kur i njëjti person ka ndihmuar më tepër se një votues më aftësi të kufizuara/ apo analfabet?	64.5	26.0	9.5
A ka pasur raste kur në kabinë kanë hyrë më tepër se një person??	25.3	70.2	4.4
A iu është dhënë votuesve fletëvotim tjetër nëse ata kanë dëmtuar të parin?	20.4	48.4	31.2

Tabela 5. Shkeljet e rregullave të procesit zgjedhor e paraqitur në përqindje.

Analizuar në aspektin e përqindjes së vendvotimeve ku janë vërejtur raste të votimit të hapur jashtë kabinave për votim, përqindja më e lartë e votimit të hapur është vërejtur në Viti, Istog dhe Lipjan, gjersa asnjë rast nuk është identifikuar në vendvotimet në Malishevë, Suharekë, Obiliq, Junik dhe Drenas. Shikuar në aspektin total më së shumti vendvotime

ku janë vërejtur raste të votimit të hapur kanë qenë Prishtina, Prizreni, dhe Gjilani.

Në aspektin e përqindjes së vendvotimeve ku është evidencuar të ketë votime familjare komuna e Mitrovicës, Ferizajt dhe Fushë Kosovës prijnë me përqindje më të lartë (shih tabelën Nr. 6), në anën tjetër më së paku vendvotime ku ka pasur votime

Komuna	Përqindja	Numri i vendvotimeve
Hani i Elezit	50.0%	5
Kaçanik	50.0%	21
Drenas	52.7%	29
Rahovec	54.8%	34
Junik	57.1%	8
Malishevë	62.8%	27
Prizren	63.2%	122
Gjakovë	63.5%	73
Obiliq	63.6%	14
Kamenice	64.4%	29
Prishtinë	65.5%	135
Skenderaj	66.2%	51
Pejë	67.0%	77
Podujevë	67.3%	70
Viti	67.3%	33
Vushtrri	68.9%	71
Suharekë	69.4%	50
Dragash	71.4%	40
Klinë	72.0%	36
Gjilan	77.1%	84
Shtime	79.3%	23
Lipjan	83.8%	57
Deçan	84.0%	42
Istog	84.4%	54
F. Kosovë	87.5%	28
Ferizaj	87.9%	102
Mitrovicë	89.9%	89

Tabela 6. Numri i vendvotimeve ku janë raportuar votimet familjare

familjare janë Hani i Elezit, Kaçanik dhe Drenas. Vlen të theksohet se nëse analizojmë numrin e vendvotimeve atëherë

Prishtina me 135 vendvotime dhe Prizreni me 122 vendvotime i prijnë listës me më së shumti qendra votimi në të cilat votimi familjar është vrojtuar.

Edhe pse në zgjedhjet komunale votuesit është dashur të votojnë për kryetar komune dhe për këshilltarët e kuvendeve komunale ku kanë pasur mundësi që së bashku me partinë të zgjedhin edhe nga një kandidat nga lista e partive, ky proces i votimit nuk ju ka marrë shume kohë. Koha mesatare e raportuar nga vëzhguesit ka qenë 5 minuta e 23 sekonda. Komuna ku votuesit kanë votuar më së shpejti ka qenë komuna e Deçanit ndërsa komuna ku votuesit kanë votuar më ngadalë ka qenë komuna e Vushtrrisë (shih tabelën 7).

Qyteti	Mesatarja e kohës/minuta
Vushtrri	8.74
Suharekë	8.40
Podujevë	7.72
Dragash	7.10
Ferizaj	6.82
Mitrovicë	4.02
Gjakovë	3.82
Prizren	3.81
F.Kosovë	3.28
Deçan	3.15

Tabela 7. Koha mesatare e votimit në rundin e parë.

Është interesante të theksohet që sipas vrojtimeve koha mesatare e votimit e raportuar për raundin e parë të zgjedhjeve ka qenë pak më e shkurtë se koha mesatare e votimit gjatë balotazhit ku mesatarja ka qenë 5 minuta e 80 sekonda. Qytetarët kanë menduar më së gjati në Vushtrri, Han të Elezit dhe në Obiliq ku mesatarisht votimi ka zgjatur më shumë se 8 minuta. Ndërsa në Novobërdë votimi ka qenë shumë më i shkurtë me mesatare nën 3 minuta dhe në Shtërpce nën 4 minuta. Sipas disa analizave, kohëzgjatja e votimit varet nga mosha, edukimi, aspekti a ka qenë i vendosur paraprakisht votuesi së për kë do të votojë dhe nga informimi mbi procesin e votimit dhe numrin e partisë dhe të kandidatit se për kë do të votojë. Personat me edukim më të ultë

kanë votuar më ngadalë, më të moshuarit poashtu. Kohëzgjatja e votimit është zgjatur nëse votuesi nuk ka ditur numrin e partisë dhe të kandidatit për të cilin ka dashur të votojë. Por disa analistë poashtu janë të mendimit që kohëzgjatja e votimit mund të jetë e zgjatur nëse votuesi ka dashur që të fotografojë votën e dhënë.

AMBIENTI I VOTIMIT

Ambienti dhe atmosfera në ditën e votimit ka qenë relativisht e qetë dhe pa incidente. Vetëm 2.5 % të vëzhguesve kanë evidentuar që në vendvotime ambienti nuk ka qenë i qetë, ndërsa në 92% të vendvotimeve është raportuar ambienti i qetë. Numri më i madh i vendvotimeve me probleme në mbajtjen e qetësisë janë raportuar në Junik ku ky problem është raportuar në 14% të vendvotimeve, në Viti në 8% të vendvotimeve dhe në Shtime në 7%.

A ka qenë ambient i qetë në vendvotim?




Figura 9. Ambienti në vendvotim.

Të pyetur se a ka pasur persona që kanë penguar procesin e votimit vetëm 2% të vëzhguesve kanë raportuar që ka pasur persona që kanë penguar procesin. Kjo dukuri më së shumti ka ndodhur në Mitrovicë dhe Ferizaj ku raste të tilla janë evidentuar

6 herë, katër raste të pengimit të procesit janë vërejtur në Vushtrri, pastaj pasojnë Prizreni dhe Skenderaj me nga tri raste. Në pesë komuna tjera kjo dukuri është raportuar nga dy herë, ndërsa në komuna tjera janë raportuar nga një apo asnjë rast.

Fshehtësia e votës nuk është respektuar vetëm në dy vendvotime, një në Pejë dhe një në Prishtinë, gjersa në shkallën e përgjithshme në 97 % të vendvotimeve është raportuar se fshehtësia e votës është ruajtur gjithmonë apo kryesisht.

Mos-prezenca e së paku tre anëtarëve të KVV-së është raportuar si problem në më pak se 1 % të vendvotimeve. Më së shumti raste kur së paku tre anëtarë të KVV-së nuk kanë qenë prezent janë raportuar në Vushtrri dhe Prizren, në këto komuna anëtarët nuk kanë qenë prezent në tre vendvotime. Në Podujevë, Ferizaj dhe Gjilan kjo dukuri është raportuar në dy vendvotime, në Prishtinë dhe Kaçanik anëtarët kanë munguar në një vendvotim.

Shumica e vëzhguesve (83%) kanë evidentuar që nuk ka pasur propagandë politike brenda vendvotimit, 12% kanë raportuar që ka pasur "pak propagandë" dhe më pak se 1% kanë raportuar "shumë propagandë". Prezenca e propagandës brenda vendvotimit është raportuar më së shumti nga Prishtina gjithsej në 4 vendvotime, pasojnë Ferizaj dhe Juniku me nga dy vendvotime.

Në vetëm 6 % të vëzhguesve kanë raportuar që ka pasur ambient të parregullt ku nuk ka pasur organizim të duhur, biseda me zë të lartë, parregullsi të theksuara procedurale dhe mungesë materialesh dhe situata të ngjajshme. Në Prishtinë raportimi i parregullsisë është bërë nga 19 vendvotime, në Pejë 16, dhe në Mitrovicë 11.

Rreth 67% të vëzhguesve nuk kanë raportuar stërbushje të vendvotimit, gjersa 26% kanë raportuar se vendvotimet kanë qenë të stërbushura në një kohë të caktuar.

Prezenca e personave të paautorizuar është raportuar në më pak se 4% të vendvotimeve. Prezenca e personave të paautorizuar është vërejtur më së shumti në Skenderaj në 12% të vendvotimeve, në Podujeve në 11% të vendvotimeve dhe në Kamenicë në 9% të vendvotimeve.




Figura 10. Vrojtimi i dukurive të ndryshme në vendvotime.

Së fundi rreth 5.6% të vëzhguesve kanë raportuar që personeli i votimit nuk kanë qenë të paanshëm në reagime ndaj ankesave, gjersa më shumë se 78% kanë deklaruar se personeli ka qenë "gjithmonë" apo "kryesisht" i paanshëm¹⁰.

A është personeli i votimit i paanshëm në reagimin ndaj ankesave?			
Gjithmonë	Kryesisht	Rrallë	Pa përgjigje
66.4	11.8	5.6	21.7

Tabela 8. Raportimi rreth paanshmërisë së personalit ndaj ankesave.

¹⁰ Në këtë pyetje (si në shumë pyetje) një pjesë e vëzhguesve (21.7%) nuk kanë pasur përgjigje kjo vjen nga fakti që nuk kanë pasur mundësi të vrojtojnë ngjarje të tillë. Pra në këtë rast nuk kanë pasur rast të vrojtojnë asnjë ankesë apo reagim ndaj ankesës prandaj nuk kanë pasur mundësi për të vlerësuar se a kanë qenë ato të paanshme.

¹¹ Për 82% që janë mbyllur mes orës 19:00 dhe 20:00 nuk mund të vlerësohet sa a ka pasur vonesa të theksuara apo a kanë qenë vonesa të shkurtra disa minutëshe

PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Mbyllja e vendvotimeve

Në shumicën e vendvotimeve votimi përfundoi mes orës 19:00-20:00¹¹. Vetëm në 17 vendvotime (apo më pak se 1%) procesi përfundoi pas orës 20:00. Në 42 vendvotime (pra në 2% prej tyre) kur u mbyllën vendvotimet ende kishte njerëz që pritnin në radhë.

Përfundimi	Numri i vendvotimeve	Përqindja
18:00-19:00	231	11.77%
19:00-20:00	1616	82.32%
20:00-21:00	3	0.15%
21:00+	14	0.71%
Pa përgjigje	99	5.04%

Tabela 9. Koha e mbylljes së vendvotimeve.

Në shumicën e vendvotimeve numërimi i votave filloi menjëherë pas mbylljes së vendvotimit, në 100 vendvotime numërimi filloi pas orës 20:00 ndërsa në 6 pas orës 21:00. Në procesin e numërimit të votave më së shumti prezencë në vendvotime kanë pasur PDK, të pasuar nga LDK, AKR, dhe LDD. Përveç vëzhguesve të Demokracisë në Veprim të cilët kanë qenë të pranishëm në të gjitha vendvotimet, vëzhgues ndërkombëtar janë vërejtur në 207 vendvotime, ndërsa mediat kanë qenë të pranishme në 68 vendvotime.

Fillimi i numërimit	Numri i vendvotimeve	Përqindja
19:00-20:00	1637	83.39%
20:00-21:00	100	5.09%
21:00-22:00	2	0.10%
22:00+	4	0.20%
Pa përgjigje	220	11.21%

në Gjilan dhe në tre vendvotime në Prishtinë, komunitat ku shiritat e sigurisë kanë qenë prekur në dy vendvotime kanë qenë në Gjakova, Podujeva dhe Vitia.

Më së shumti probleme në numërimin e votave dhe në regjistrimin e tyre ka pasur në Lipjan, pas të cilës kanë ardhur Vushtrria dhe Podujeva të cilat në aspektin e numrit të vendvotimeve ku nuk ka pasur numërim kanë qenë të parat me nga 16 vendvotime.

Tabela11. Respektimi i rregullave gjatë numërimit.

Respektimi i rregullave gjatë numërimit	Po	Jo	Pa përgjigje
A kishin vëzhguesit shikim të mirë në procedura?	94.1	0.7	5.2
A u kontrolluan shiritat sigures para hapjes së kutisë?	96.3	0.4	3.4
A janë shiritat sigures të paprekur?	95.3	1.0	3.7
A u numëruan dhe a u regjistruan nënshkrimet në listën e votuesve?	91.0	0.4	8.6
A u numëruan dhe u regjistruan fletëvotimet e përdorura?	85.5	6.5	8.0
A u numëruan dhe u regjistruan fletëvotimet e prishura dhe të refuzuara?	76.1	7.9	15.9
A u verifikuan dhe regjistruan shiritat e sigurisë?	93.3	0.7	6.1
A u vendosën anash materialet e votimit?	88.0	0.8	11.2

Tabela10. Koha e fillimit të numërimit të votave.

Në 6 vendvotime janë evidentuar persona të paautorizuar gjatë procesit të numërimit, në dy vendvotime në Ferizaj, dhe në nga një vendvotim, në Kaçanik, Mitrovicë, Rahovec, dhe Podujevë.

Numërimi

Në aspektin e numërimit problemi më i raportuar ka qenë që në shumë vendvotime fletëvotimet e prishura dhe të refuzuara nuk u numëruan dhe nuk u regjistruan. Po ashtu në rreth 6.5% të vendvotimeve të vëzhguara fletëvotimet e përdorura nuk u numëruan dhe nuk u regjistruan. Në 1% të vendvotimeve shiritat e sigurisë kanë qenë të prekur. Shiritat sigures kanë qenë të prekur në katër vendvotime

Qyteti	Numri i vendvotimeve	Përqindja
Klinë	3.00	6.0%
Pejë	7.00	6.1%
Viti	3.00	6.1%
Prizren	12.00	6.2%
Gjakovë	8.00	7.0%
Shtime	3.00	10.3%
Skenderaj	9.00	11.7%
Podujevë	16.00	15.4%
Vushtrri	16.00	15.5%
Lipjan	11.00	16.2%

Tabela 12. Numri i vendvotimeve ku nuk janë numëruar votat e prishura dhe të refuzuara.

Lipjani po ashtu ka qenë ndër komunat me përqindje më të lartë të vendvotimeve ku nuk janë numëruar dhe regjistruar votat e prishura dhe të refuzuara. Në aspektin e numrit total të vendvotimeve ku nuk janë numëruar votat e prishura dhe të refuzuara, Podujeva ka qenë e para me 18 raportime, pastaj Prishtina me 16, Prizreni dhe Vushtrria kanë pasur nga 15.

Qyteti	Numri i vendvotimeve	Përqindja
Gjilan	8	7.34%
Prishtinë	16	7.77%
Prizren	15	7.77%
Pejë	9	7.83%
Viti	4	8.16%
Gjakovë	11	9.57%
Shtime	3	10.34%
Skenderaj	11	14.29%
Vushtri	15	14.56%
Podujevë	18	17.31%
Lipjan	12	17.65%

Tabela 13. Numri i vendvotimeve ku nuk janë numëruar votat e dëmtuara apo të refuzuara.

trigon shkelje në më pak se 1% të vendvotimeve, kjo shkelje ka qenë e koncentruar në Deçan ku ka ndodhur në 9 vendvotime apo 18% të vendvotimeve në këtë komunë.

Në aspektin e vendosjes së fletëvotimeve të pavlefshme anash si dhe futja e votave në thes transparent dhe a ishin këto të dukshëm për vëzhguesit dhe KVV-në gjithë kohën nuk janë raportuar probleme të dukshme. Vlen të theksohet që në Prishtinë, Podujevë dhe Fushë Kosovë është raportuar që në dy vendvotime në çdonjërin nga këto komuna nuk janë vendosur anash fletëvotimet e pavlefshme.

Tek fletëvotimet me kusht, të pyetur a janë numëruar zarfet e hapura ndaras dhe a janë shënuar si të pavlefshme vëzhguesit në 8% të vendvotimeve kanë thënë që kjo nuk ka ndodhur, gjersa në 15% të vend

votimeve është raportuar që kjo ka ndodhur. Në anën tjetër në 77% të vendvotimeve nuk është raportuar për këtë çështje ndoshta për shkak që nuk ka pasur zarfe të hapura pra nuk ka pasur fletëvotime me kusht të pavlefshme.

Tabela 14. Procesi i numërimit.

	Për Kuvendet Komunale			Për Kryetar Komune		
	Jo	Po	Pa përgjigje	Jo	Po	Pa përgjigje
A u vendosën anash fletëvotimet e pavlefshme?	0.4	84.3	15.3	0.6	90.0	9.5
Pas numërimit të votave a u futën ato në plastik transparent?	0.0	80.2	19.8	0.1	90.1	9.8
A ishte thesi transparent i dukshëm për KVV-në dhe vëzhguesit gjatë gjithë kohës?	0.3	83.0	16.7	0.1	90.9	9.0

Vlen të theksohet që në aspektin e mosverifikimit dhe mosregjistrimit të shiritave të sigurisë së kutive kjo shkelje ka ndodhur në një numër të vogël të vendvotimeve. Por edhe pse analiza e përgjithshme

Në përgjithësi vlerësimi i vëzhguesve ka qenë që numërimi funksionoi normal por është me rëndësi të theksohet se diku rreth 5% kanë shënuar që pati disa parregullsi dhe diku rreth 1% që ka pasur par-

Koha e përfundimit të numrimit të votave.




Figura 11. Koha e përfundimit të numërimit.

A janë numëruar zarfet e hapura ndaras dhe a janë shenuar si të pavlefshme?




Figura 12. Numërimi i zarfeve të hapura të fletëvotimeve me kusht

regullsi serioze që kanë mundur të ndikojnë në rezultate. Nga vëzhguesit që kanë raportuar që ka pasur parregullsi serioze që kanë mundur të ndikojnë në rezultate 4 kanë qenë në Pejë, nga dy vendvotime janë raportuar në Ferizaj, Rahovec, Viti, dhe Vushtrri dhe nga një në Skenderaj, Prizren, Prishtinë dhe Dragash.

Sipas hulumtimit të opinionit rreth 69% të qytetarëve besojnë që rezultatet zgjedhore kanë pasqyruar mënyrën se si njerëzit kanë votuar, gjersa 21% mendojnë se rezultatet nuk pasqyrojnë mënyrën e të votuarit.

Vlerësimi i procesit të numërimit




Figura 13. Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të numërimit.

Rezultatet zgjedhore në mënyrë të drejtë kanë pasqyruar mënyrën se si njerëzit kanë votuar




Figura 14. Besimi në rezultate.

PËRFUNDIMET E DITËS SË ZGJEDHJEVE DHE BALOTAZHIT

Sipas raportimeve të mbledhura nga vëzhguesit e "Demokracisë në Veprim" rreth ecuresë së ditës së zgjedhjeve të mbajtura me 15 nëntor 2009 si dhe më 13 dhjetor 2009, përkundër faktit që u përmbushën shumica e standardeve universale të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të barabarta, dita e zgjedhjeve në Kosovë u karakterizua me një varg shkeljesh, ku sipas të dhënave që posedohen, kryesisht kanë qenë të natyrës së njëjtë në shumicën e vendvotimeve, përveç disa qendrave ku shkeljet ishin më të rënda. Sipas të dhënave të mbledhura nga "Demokracia në Veprim" parregullsi të ndryshme gjatë ditës së zgjedhjeve ka pasur në 126 vendvotime ose në 5.6% të totalit të vendvotimeve.

Në disa vendvotime nuk janë kontrolluar dokumentet identifikuese, pastaj ka pasur mungesë të materialit në vendvotime duke krijuar mundësi për manipulime. Këto parregullsi në pikat e votimit krijuan hapësirë që personat të votojnë më shumë se një herë, e në rastet më flagrante të votojnë edhe deri në 30 herë në një vendvotim¹².

Shumë i pranishëm ka qenë edhe votimi familjar i cili është vërejtur në më se 70% të vendvotimeve, kur dy e më shumë persona futen në kabinën e votimit duke ndikuar njëri tjetrin, pastaj edhe asistencë e shumëfishtë që ofronin personat e njëjtë brenda pikave të votimit është raportuar në 26% të vendvotimeve.

Ndër shkeljet më të mëdha ishin edhe parregullsitë nga ana e komisionarëve të cilët ndërhyjnë në votat me kusht, pastaj votuan më shumë se një herë, nënshkruanin në emër të personave në mënyrë që të barazoheshin fletëvotimet me nënshkrimet në lista si dhe shpesh zëvendësoheshin nga vëzhguesit par-

¹² Demokracia në Veprim. Deklaratë për procesin e raundit të parë të zgjedhjeve të mbajtura me 15 nëntor. Nëntor 2009, Prishtinë

tiak në punët teknike. Ka pasur raste kur komisionarët ndërhyjnë në fletëvotime, p.sh duke i vendosur fletëvotimet me kusht në kutitë me fletëvotime të rregullta, duke shënjuar kandidatët për kuvend komunal sipas dëshirës në rastet kur votuesit kishin votuar vetëm subjektin politik, pastaj duke votuar më shumë se një herë si dhe duke nënshkruar në listën e votimit që t'u përputhen votat në kuti me nënshkrimet e votuesve. Sa i përket vëzhguesve partiak shkeljet e tyre ishin të natyrës së asistencës së shumëfishtë, shpesh kryenin funksionin e komisionarëve duke bërë spërkatjen e gishtërinjve, si dhe presionin e kohëpaskohshëm në votues që të votohet ai subjekt politik.

Në disa vendvotime nëpër komuna të ndryshme ka pasur ndërhyrje të personave të paautorizuar të cilët provonin të imponoheshin me dhunë për të ndikuar në pikat e votimit, në disa raste kishte ndërhyrje edhe policia mirëpo kryesisht ishin të natyrës verbale. Fjalosje dhe mosmarrëveshje kishte edhe në mes të komisionarëve e shpesh në to përfshiheshin edhe vëzhguesit e partive.

Parregullsitë në listat e votimit shkaktuan tollovi dhe huti tek qytetarët pasi që shumë persona nuk gjenin emrin në lista dhe detyroheshin të lëviznin nga qendra në qendër. Nuk munguan as konfliktet verbale, presionet politike e fushatat me simbole partiake nëpër qendrat e votimit.

Në disa pika votimi pas mbylljes së vendvotimit, vëzhguesve iu mohua e drejta të vëzhgojnë numërimin e votave ngase nuk kishin shikim të mirë në procedurën e votimit. Ky problem është raportuar nga 13 vendvotime.

Verifikimi i dokumenteve të identifikimit nuk u bë në mënyrë të rregullt në 47 vendvotime. Në 3 vendvotime identifikimi dhe verifikimi dokumenteve bëhej rrallë, kjo ka ndodhur në dy vendvotime në Junik dhe në një vendvotim në Shtime. Në disa pika vendvotimesh votuesit lejoheshin të votonin pa mjete iden-

tifikimi apo edhe nuk u kërkoheshin fare, përderisa persona të tjerë janë refuzuar të votojnë me kopje të letërnjoftimit.

Në shumë vendvotime janë hasë persona që votuan disa herë radhazi, kjo për shkak të mungesës së kontrollimit të duhur të listës, gishtit të spërkatur apo edhe anashkalimit të plotë të procedurave të rregullta verifikuese.

Votimi familjarë apo prezenca e dy e më shumë persona në kabinën e votimit kanë qenë shumë të shprehura gjatë procesit të votimit. Edhe pse radhë në frekuencë rastet e votimit familjar janë evidentuar në 70% të vendvotimeve sidomos me persona më të moshuar.

Po ashtu të shumta kanë qenë rastet kur personi i njëjtë asistoi dhe shoqëroi në kabinën e votimit një e më shumë votues. Kjo dukuri është raportuar në 26% të vendvotimeve. Në shumë raste është vërejtur që këta persona janë simpatizantë të partive apo të kandidatëve të ndryshëm.

Në shumë pika votimi procesi është ngadalësuar e në disa raste është mbyllur për një kohë të caktuar për shkak të mungesës së materialeve të nevojshme për vendvotimin. Në rastet kur nuk funksiononte llamba për kontrollimin e gishtërinjve krijohet hapësirë për votim të shumëfishtë.

Parregullsitë në listat e votimit kanë qenë një ndër elementet që shkaktuan mjaft komplikime gjatë procesit të votimit. Në rreth 35% të vendvotimeve rastet kur votuesi nuk ka mundur të gjej emrin në listë është raportuar si dukuri e shpeshtë. Kjo dukuri ka ndodhur më shpesh në Viti, Istog, Han të Elezit, Gjakovë dhe Pejë. Shumë persona, sidomos në komunën e Pejës, kanë hasur në probleme pasi që emrat e tyre nuk ndodheshin në qendrat e votimit ku ata kishin votuar vazhdimisht dhe për shkak të mungesës së informatave për votuesit, ata detyroheshin të endeshin nga qendra në qendër. Përveç

kësaj emrat e personave tanimë të vdekur si dhe emrat e personave që jetojnë jashtë Kosovës krijuan mundësi për manipulim votash. Kishte edhe qendra ku votohej në errësirë dhe pa u kontrolluar listat fare.

Në 68 vendvotime, pra në 3% të vendvotimeve materialet propagandistike të partive nuk janë hequr nga hapësira e më pak se 100 metrave nga vendvotimi. Po ashtu gjatë procesit të votimit nuk mungoi as presioni politik mbi votuesit si dhe kampanja përmes simboleve partiake.

Vonesa mesatare e hapjes së vendvotimeve ka qenë diku rreth 15 – 20 min vonesë, përveç rasteve kur qendrat e votimit nuk janë hapur fare. Ndërsa sa i përket mbylljes së vendvotimeve ka disa raste të raportuara ku vëzhguesve iu mohua e drejta të jenë prezent gjatë numërimit të votave apo edhe të marrin rezultatin përfundimtar.

RIVOTIMET NË KOMUNAT E PRIZRENIT DHE LIPJANIT

Parregullsitë e gjetura në raundin e dytë të zgjedhjeve në dhjetor 2009 në komunat e Prizrenit dhe Lipjanit, kanë zbehur në një masë parimet e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Kjo ka bërë që për herë të parë që nga zgjedhjet e para të vitit 2000 të anulohen rezultatet complete në dy komuna, duke u vendosur për rivotim.

Sipas raporteve të 300 vëzhguesve të Demokracisë në Veprim, raundi i tretë i votimeve edhe pse me probleme të përsëritura ka qenë shumë më afër parimeve të zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Një kontribut shtesë në cilësimin e këtij rundi të tretë të zgjedhjeve si të lirë dhe të drejtë ishte pjesëmarrja e lartë e qytetarëve në votime.

Në bazë të të gjeturave të vëzhguesve Demokracia në Veprim ka konkluduar¹³ që rivotimi në komunat e Prizrenit dhe Lipjanit i ka përmbushur kënaqshëm standardet për zgjedhje të lira dhe të drejta, përkundër disa parregullsiqe që janë vërejtur. Ndër parregullsitë kryesore që kanë hasur vëzhguesit e Demokracisë në Veprim dhe që po e përcjellin vazhdueshëm procesin zgjedhor në Kosovë kanë qenë:

1. votimet familjare;
2. prezenca e vazhdueshme e personave të paautorizuar nëpër vendvotime;
3. asistimi i votuesve nga ana e vëzhguesve të partive politike;
4. keqpërdorimi i pozitës së menaxherëve të qendrave të votimit;
5. votimet e hapura; dhe
6. fotografimi i votave nga shoqëruesit e votuesve.

Këto parregullsiqe të evidentuara nuk kanë qenë në atë shpeshësi që të ndikojnë në rezultate por më shumë kanë qenë raste të rralla dhe sporadike të cilat nuk janë evituar dhe parandaluar.

Demokracia në Veprim ka kërkuar nga KQZ-ja dhe palët tjerat të përfshira në proces që të punojnë së bashku në mënyrë që t'i evidentojnë këto parregullsiqe nga ky proces i gjatë zgjedhor dhe t'i evitojnë ato duke rishikuar formën e funksionimit të mekanizmeve dhe legjislacionit zgjedhor.

¹³ Deklaratë mbi procesin e rivotimit në komunat e Prizrenit dhe Lipjan. Demokracia në Veprim. Prishtinë, 2010.

ANALIZA E TRENDEVE

Pjesëmarrja në votime

Që nga zgjedhjet e viti 2000 ku pjesëmarrja në votime ka qenë 79% është vërejtur një rënie konstante dhe drastike në numrin e qytetarëve me të drejtë vote që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje. Ky trend është ndalur në zgjedhjet e fundit ku kemi një rritje pozitive në krahasim me vitin 2007 ku përafërsisht

politike nuk ka pasur ndonjë risi në spektrin politik.

Sipas hulumtimit, trendi i pjesëmarrjes në votime lidhet me faktorë demografik si edukimi. Pra me rritjen e edukimit kemi rritje të pjesëmarrjes në votime. Pjesëmarrja më e ultë është raportuar nga respondentët me shkollë fillore të pakryer, pas këtij grupi numri i atyre që kanë dalur në votime është rritur me rritjen e edukimit. Ky trend ka vazhduar deri te grupi

i respondentëve me studime post-diplomike ku numri i atyre që kanë dalë në votim ka një rënie në krahasim me grupet paraprake.

Komuna me pjesëmarrje më të lartë në votime ishte Mamusha me 65% të votuesve të regjistruar që kanë përdorur të drejtën e tyre qytetare, pasojnë




Figura 14. Numri i votuesve të regjistruar për vitet 2000-2009.

pjesëmarrja është ngritur për 3% dhe tani është në 43.2%. Në anën tjetër edhe pse numri i atyre që kanë qenë të regjistruar me të drejtë vote është rritur në mënyrë konstante që nga viti 2000, puna rigoroze në pastrimin e listave ka bërë që në vitin 2009 në krahasim me vitin 2007 kemi një rënie të vogël. Ky mund të jetë shpjegim më i mirë për rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes në zgjedhje ngase nga perspektiva e zhvillimeve

Skenderaj më pak se 63%, Drenasi me rreth 62%, ndërsa komunat me përqindje më të ulët në votime kanë qenë komunat e veriut, Zveçani, Leposaviqi

Pjesëmarrja në votime




Figura 15. Pjesëmarrja në votime 2000-2009.

Votimi në zgjedhje





Figura 16. Edukimi dhe pjesëmarrja në zgjedhje.

Edukimi

Pjesëmarrja në votime



dhe Zubin Potoku. Vlen të theksohet se në komuna tjera ku ka një shumicë të popullsisë serbe ka pasur një pjesëmarrje të konsiderueshme me mbi 20%, ky trend u vërejt si në komunat e vjetra poashtu në ato komuna të reja të krijuara para këtyre zgjedhjeve.

Në aspektin e trendit, në krahasim me zgjedhjet e vitit 2007 shumica e komunave ka pasur një trend të rritjes së pjesëmarrjes në votime. Në 26 komuna përqindja e pjesëmarrjes në votime është rritur. Rritje më të madhe kanë pasur Vitia (15%), Kamenica (13%) dhe Obiliqi (13%). Por në 6 komuna pjesëmarrja në votime ka qenë më e vogël se në vitin 2007. Rënie më të madhe ka treguar elektorati në komunën e Shtimës (4%), pastaj në komunën e Deçanit (4%) dhe në Novobërdë (2%).

Figura 17. Trendi i pjesëmarrjes në votime më 2007 dhe 2009 sipas komunave.

Në anën tjetër edhe pse janë vërejtur dallime të vogla në aspektin e gjinisë, ashtu që meshkujt kanë dalur më shumë në votime se sa femrat, dallimi nuk ka qenë i rëndësishëm. Poashtu dallimet ndërmjet grupmoshave të ndryshme nuk janë të theksuara, i vetmi trend devijues është ai i personave mbi moshën 65 vjeçare që kanë raportuar dalje më të ulët në zgjedhjet e 15 nëntorit.

Në anën tjetër analiza e atyre që tregojnë interes në politikë pra shikojnë lajmet në TV dhe atyre që nuk shikojnë lajmet tregon që ka diferencë në aspektin e votimit. Personat që nuk shikojnë lajmet kanë shumë më pak gjasa që të dalin në votime dhe e kundërta me rritjen e numrit të orëve të kaluara pranë TV-së rritet edhe përqindja e daljes në votime.




Figura 18. Mosha dhe pjesëmarrja në zgjedhje.




Figura 19. Interesimi për lajme dhe votim.

ANALIZA E MOS-DALJES NË ZGJEDHJE

Sipas hulumtimit të opinionit arsyeja kryesore e atyre që nuk kanë votuar më datën 15 nëntor ka qenë që nuk janë të interesuar për zgjedhje dhe për politikë. Pos kësaj arsyeje, diku rreth 21% kanë thënë që nuk kanë mundur të marrin pjesë në zgjedhje për arsye personale si sëmundje, udhëtim, shkaku që nuk banojnë në vendin e regjistruar, etj. Në aspektin

Cila është arsyeja se pse nuk keni votuar:




Figura 20. Arsyet e raportuara për mos-dalje në votime.

e arsyetimit që votuesi nuk sheh perspektivë tek politika momentale diku rreth 16% kanë thënë që për ta të gjitha partitë duken të njëjta dhe diku rreth 6 % beson se vota e tyre nuk do të sjell ndryshime. Arsyen e mosregjistrimit për të votuar e kanë dhënë

diku rreth 7.5% të respondentëve gjersa largësia nga qendra e votimit ka qenë arsyeja e 2 % të anketuarve.

Pjesa me e madhe e qytetarëve të anketuar kanë dalur në zgjedhje për shkak se besojnë që në këtë mënyre gjërat do të përmirësohen dhe do të kenë një të ardhme më të mirë. Pastaj pasojnë ata që mendojnë që do të përmirësohet situata ekonomike dhe ata që besojnë që me votim do të vijnë ndryshimet. Vlen të theksohet se premtimet e partive janë raportuar si motiv vetëm nga ana e 1% të repondentëve.

Gjersa miqtë apo familjarët kandidatë kanë qenë motiv për 2.4% të respondentëve.

Pse keni votuar në zgjedhjet e 15 nëntorit?	Përqindja
Për një të ardhme me të mirë/kështu që gjërat do të përmirësohen	44,2
Për të bërë një ndryshim	15,6
Për të përmirësuar situatën ekonomike	16,6
Përkrahur partinë/Besim të madh në partinë ose kandidatin	6,0
Përmirësuar mundësinë e punësimit të të rinjve	8,9
Arritur demokraci, liri	3,0
Profesionalizmin e partisë/kandidatit	0,9
Sinqeritetin/Ndershmërinë e partisë/kandidatit	0,7
Premtimet përgjatë fushatës elektorale/platformën e partisë/	1,0
Kam pas miqtë/ familjare si kandidate	2,4
Tjetër	0,6
Total	100

Të pyetur se sa e reflektojnë vullnetin e qytetarëve zgjedhjet, pra a janë pasqyruar votat e qytetarëve në rezultate, 69% besojnë që po, gjersa 20% i qytetarëve thonë që rezultatet nuk pasqyrojnë votat, dhe 10 % nuk kanë shprehur mendimin e tyre për këtë çështje.

Të pyetur për kënaqshmërinë e tyre me aspekte të ndryshme të përgatitjeve dhe informimit për zgjedhjet, qytetarë kanë

Tabela 15. Motivet e raportuara për votim.

Të pyetur për kënaqshmërinë e tyre me aspekte të ndryshme të përgatitjeve dhe informimit për zgjedhjet, qytetarë kanë

PERCEPTIMET DHE MENDIMET RRETH ZGJEDHJEVE

Në përgjithësi hulumtimi i opinionit i zhvilluar nga Demokracia në Veprim ka treguar që qytetarët besojnë që zgjedhjet kanë qenë të lira dhe demokratike me, ku 41% besojnë që zgjedhjet kanë qenë plotësisht të lira dhe demokratike, ndërsa 37% kanë deklaruar që zgjedhjet ishin deri diku të lira dhe demokratike. Ndërsa pak më shumë se 11% besojnë që zgjedhjet nuk kanë qenë të lira dhe demokratike.

■ Të kënaqur ■ Të kënaqur deri diku □ Të pakënaqur dhe nuk di




Figura 21. Kënaqshmëria me informim dhe administrim.

qenë më të kënaqur me procesin e regjistrimit të votuesve (79%), pastaj me informimin mbi atë se ku dhe kur do të votohet (79%), për 75% të qytetarëve kanë qenë të kënaqur me efikasitetin e policisë, gjersa kompetencën e komisionarëve e kanë pëlqyer 70% të qytetarëve të anketuar.

Sipas hulumtimit të opinionit rreth 70% të kosovarëve besojnë që vota e tyre është mbajtur e fshehtë nga autoritetet zgjedhore, kjo përqindje është brengosëse ngase si një nga rregullat më të thjeshta të procesit zgjedhor e drejta për votën e fshehtë besohet që nuk është respektuar.

Po ashtu është brengosësh fakti që vetëm 35.5% besojnë që zgjedhjet kanë qenë të administruara në mënyrë kompetente.

Në aspektin e besimit që prania e vëzhguesve ka ndikuar pozitivisht në legjitimitetin e zgjedhjeve, besimi më i madh ka qenë ndaj vëzhguesve të pavarur vendor, pastaj vëzhguesve ndërkombëtar, gjersa besimi ndaj vëzhguesve të partive politike ka qenë më i vogël (shih Figurën 22).

Në aspektin e vlerësimit të lidërshipt partiak vërehet që një pjesë e madhe e qytetarëve të cilët janë simpatizantë të ndonjë partie besojnë që dega e partisë së tyre duhet të ketë një garë të hapur ndërmjet individëve për kryetar të degës. Po ashtu një pjesë bukur e madhe beson që dega e partisë së tyre duhet të ketë autonomi më të madhe në politikat




Figura 22. Mendimet e qytetarëve rreth administrimit të zgjedhjeve.

lokale. Rreth 39% i simpatizantëve besojnë që udhëheqësi i degës së partisë gëzon përkrahje në nivelin lokal, gjersa 37% është shprehur që beson më shumë lidërshipt qendror të partisë se sa udhëheqjes së degës lokale.

Në aspektin e involvimit në fushatën zgjedhore çdo i treti votues që ka votuar në zgjedhjet komunale 2009 ka qenë i kontaktuar personalisht nga ndonjë prej kandidatëve apo dikush nga partitë politike për të votuar për ta. Në krahasim me këtë, të pyetur për motivin e votimit është interesante që vetëm 2.5% të respondentëve kanë votuar për shkak të miqve apo familjarëve që kanë qenë kandidatë.

Besimi tek lidershipi partiak




Figura 23. Besimi tek lidershipi partiak.

Për më tepër çdo i pesti Kosovar ka treguar mbështetjen personale për ndonjë parti apo kandidat miqve dhe familjarëve të tij gjatë fushatës zgjedhore, gjersa më shumë se gjysma e qytetarëve këtë nuk e kanë shprehur asnjëherë.

Gjatë fushatës elektorale, ju ka ndodhur që ndonjë prej kandidatëve ose dikush nga partitë politike të ketë kontaktuar me ju për t'ju bindur për të votuar për ta?




Figura 24. Fushata elektorale në baza personale.

Gjatë fushatës elektorale, a keni treguar mbështetjen tuaj për ndonjë parti ose kandidat




Figura 25. Tregimi i mbështetjes personale gjatë fushatës elektorale.

Rekomandime

- Përdorimi i të miturve nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore duhet të evidentohet dhe të parandalohet nga institucionet përkatëse, mënyra për të arritur këtë mund të jenë dënime më rigorozë për përdorim të të miturve gjatë fushatës;
- Përdorimi i burimeve administrative qeverisëse në radhë të parë të veturave zyrtarëve, objekteve qeverisëse, burimeve financiare si dhe e shërbyesve civil duhet të evitohet. Në të ardhmen autoritetet qeveritare duhet të shmangen nga përdorimi i burimeve administrative gjatë rrjedhës së fushatës;
- Listat e votuesve edhe pse janë azhurnuar dhe përmirësuar ato ende kanë probleme dhe një numër i madh i qytetarëve nuk ka mundur të gjej emrin e tyre në lista si rrjedhojë e ndërrimit të vendvotimit, kjo ka bërë poa shtu të ketë një numër të konsiderueshëm të votave me kusht të cilat ngadalësojnë procesin e numërimit dhe mundësojnë manipulime. Listat e votuesve duhet të rifreskohen rregullisht dhe në mënyrë transparente. Kjo do të mundësonte shmangien e votave me kusht, si dhe manipulimet që mund të ndodhin për shkak të mos-pastrimit të listave;
- Devijimet nga procedurat dhe rregullat e procesit zgjedhor kanë qenë të mundura nga mosreagimi dhe tolerimi i komisionerëve të KQZ-së në vendvotimet e ndryshme. Në këtë aspekt për të arritur standardet ndërkombëtare elektorale anëtarët e komisioneve të vendvotimeve duhet të zbatojnë procedurat votuese në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe udhëzimet e lëshuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor dhe nuk duhet të lejojnë lëshime;
- Jo të gjithë komisionarët në vendvotimeve i janë përmbajtur saktësisht procedurave të numërimit dhe të paketimit të votave gjë që rezultoi që disa materialet zgjedhore të mungonin. Dhe kjo së fundi rezultoi në vonesa në numërim pasi që materialet në vendvotimeve duhej të vendoseshin në karantinë në pritje të hetimeve të mëtejme. Për të shmangur raste të tilla KQZ-ja duhet që të trajtojë më mirë komisionarët dhe po ashtu që të krijoj mekanizma të llogaridhënies së brendshme për stafin që ka punuar në vendvotime ku janë hasur probleme;
- Është me rëndësi për zgjedhjet e ardhshme që veprimet e komisionarëve të vendvotimeve që ishin në kundërshtim me procedurat dhe rregullat e procesit zgjedhor të konsiderohen si vepra penale dhe si të tilla ndiqen nga institucionet përkatëse;
- Duhet po ashtu të krijohen programe të vazhdueshme dhe të përhershme për edukimin e shoqërisë në përgjithësi dhe për votim të gjerë në veçanti. Fushatat e ardhshme duhet të përmbajnë programe për edukimin e votuesve për të kuptuar procedurat zgjedhore, për të respektuar dhe evidentuar parregullsitë;
- Gjatë këtyre zgjedhjeve KZAP ka pranuar shumë ankesa dhe parashtresa, shumica e parashtresave të pranuar kanë rezultuar në vendime, por vendimet më të debatuar të KZAP-it i kishin të bëjë me zhvleftësimin e rezultateve në një numër të konsiderueshëm të vendvotimeve si rezultat i veprimeve mashtruese të stafit të vendvotimit të ndërlidhur me manipulimin të votave. Në këtë aspekt mospërsëritja e votimeve në këto vendvotime ka bërë që një numër i madh i qytetarëve të humbë drejtën e votës dhe mundësinë për të shprehur vullnetin e tyre për shkak të mosmirësjelljes së stafit të vendvotimit;

- Çështjet procedurale në zgjedhjet e ardhshme duhet të përmirësohen duke larguar personelin i cili ka qenë në vendvotimet në të cilat ka pasur probleme dhe duke rekrutuar personelin e njëjtë i cili ka punuar në vendvotime ku nuk ka pasur probleme. Emërimi i drejtorëve të shkollave si menaxher të qendrave të votimit ka shpjerë në ankesa për anueshmëri politike ngase në shumë raste emërimi i drejtorëve bëhet nga linjat politike. Në të ardhmen kjo praktikë duhet të rishqyrtohet. Për më tepër ndoshta duhet të shqyrtohet mundësia e ndërrimi të personelit ndërmjet komunave të ndryshme ashtu që të tejkalohet problemi i afërsisë së zyrtarëve dhe të votuesve.
- KQZ-ja duhet të zhvillojë kapacitete më të forta menagjeriale dhe kapacitete trajnuese;
- Krijimi i vendkalimeve për personat me aftësitë kufizuar është një kriter që duhet t'a përm-bushin të gjitha shkollat pa marrë parasysh zgjedhjet. Si vend pas konfliktit, Kosova ka një numër të madh të personave me aftësi të kufizuara, dhe ky është një investim i vogël për shërbimin që kryen. Një gjë e tillë mund të rregullohet lehtë nga KQZ-ja në bashkëpunim me autoritetet komunale dhe shkollore. Gjithashtu duhet të bëhet çmos për t'ju mundësuar personave të verbër që të votojnë personalisht në vendvotim.

Aneks 1:

Hulumtimi i opinionit

Hulumtimi i opinionit është organizuar nga koalicioni i organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim, ku anëtarët e 16 organizatave joqeveritare kanë kryer hulumtimin në terren gjatë periudhës 9-16 dhjetor 2010.

Hulumtimi i opinionit është kryer me mostër probabile me përzgjedhje probabile me disa hapa (multi-step) duke përdorur metodën e intervistës të së drejtpërdrejt personale, ku anketuesit kanë lexuar pyetjet dhe i kanë rrethuar apo shënuar përgjigjet e respondentëve.

Numri i respondentëve të intervistuar ka qenë 983, në bazë të përkatësisë etnike janë intervistuar 890 shqiptarë, 51 serbë, 42 të komuniteteve të tjera (boshnjakë, goranë, turk, romë, ashkali, egjiptas dhe kroat).

Shpërndarja e mostrës sipas rajoneve është si vijon:

	Frekuenca	Përqindja
Zonë rurale	38	3,9
Fshat	432	43,9
Qytet	457	46,5
Prishtinë	56	5,7
Total	983	100

Tabela A1. Numri i repondentëve sipas regjionit.

	Frekuenca	Përqindja
Prishtinë	215	21,9
Mitrovicë	122	12,4
Prizren	145	14,8
Gjakovë	68	6,9
Gjilan	177	18,0
Pejë	149	15,2
Ferizaj	107	10,9
Total	983	100

Tabela A2. Numri i respondentëve sipas vendbanimit.

Aneks 2:

Historiku i shkurtë i zgjedhjeve për qeverisje lokale në Kosovë¹⁴

Zgjedhjet komunale 2000. Në Republikën e Kosovës, që prej vitit 2002 janë mbajtur pesë palë zgjedhje. Zgjedhjet e para për pushtetin lokal, u mbajtën më 28 tetor të vitit 2000. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 913.179, kurse pjesëmarrja në votime 79%. Në këto zgjedhje është votuar me lista të hapura, për një kandidat të vetëm. Votimet u zhvilluan në 30 zona elektorale. Nga 920 ulëse, u zgjodhën 869 këshilltar dhe në tri komuna u emëruan. Nuk kishte vende të rezervuar. U votua në 1.464 vendvotime dhe pati 380 qendra votuese. Këto zgjedhje i vëzhguan 13.976 vëzhgues.

Zgjedhjet komunale 2002. Zgjedhjet e dyta për pushtetin lokal, u mbajtën më 26 tetor të vitit 2002. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 1.320.481, kurse pjesëmarrja në votime 54%. Këto zgjedhje u bënë me lista të mbyllura, dhe u votua vetëm për subjektin politik. Subjektet politike, i caktuan kandidatët e tyre në listë. 1/3 e kandidatëve deputet, është përcaktuar në bazë të gjinisë. Gjithsej, kishte 30 zona elektorale. U zgjodhën 920 këshilltar dhe, nuk kishte vendetë rezervuara. U votua në 1.727 vendvotime dhe pati 503 qendra votuese.

Zgjedhjet komunale 2004. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, u mbajtën më 23 tetor të vitit 2004. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 1.412.680, kurse pjesëmarrja në votime 49.52%. Këto zgjedhje u bënë me lista të mbyllura, dhe u votua vetëm për subjektin politik. Subjektet politike, i caktuan kandidatët e tyre në listë. Kishte një zonë elektorale (Kosova). U zgjodhën 100 deputet dhe, nuk kishte vendetë rezervuara. 1/3 e kandidatëve deputet, është përcaktuar në bazë të gjinisë së kundërt. U votua në 1.662 vendvotime dhe kishte 557 qendra votuese. Për votim me nevoja të veçanta, u organizuan 86 ekipe për 5.306 votues. Këto zgjedhje i vëzhguan, 12.916 vëzhgues.

Zgjedhjet 2007- ish-in Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, për Kuvendet Komunale dhe për Kryetar të Komunave. Zgjedhjet e vitit 2007, u mbajtën më 17 nëntor. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 1.454.174. Kurse, më 8 dhjetor, u zhvillua rundi i dytë për Kryetar të Komunave. Pjesëmarrja në votime për Kuvendin e Kosovës: 54%. Për Kuvendet Komunale: 39.4%. Për Kryetar të Komunave: 395. Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, zgjedhjet për Kuvendet Komunale: votë për subjektin dhe votim deri në 10 kandidatë; zgjedhjet për Kryetar të Komunave: votë vetëm për një kandidat, u zhvilluan me lista të hapura. Për herë të parë, u vendos 'pragu elektoral' prej 5%. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, u zhvilluan si një zonë elektorale. Zgjedhjet për Kuvendet Komunale, u zhvilluan në 30 zona elektorale. Dhe, zgjedhjet për Kryetar të Komunave, gjithashtu në 30 zona elektorale. Zgjedhjet siguruan 100 deputet për Kuvendin e Kosovës, për Kuvendet Komunale 920 këshilltar, për Kryetar të Komunave 30 dhe, u bënë emërimet në pesë komuna/ katër kryetar të komunave të emëruar. Vende të rezervuara për Kuvend të Kosovës: 20. Kurse 1/3 e kandidatëve, është përcaktuar në bazë të gjinisë së kundërt. Në këto zgjedhje, u votua në 2.323 vendvotime dhe, kishte 621 qendra votuese. Për votim me nevoja të veçanta, u organizuan 108 ekipe, për 6.372 votues. Këto zgjedhje i vëzhguan, 27.000 vëzhgues.

Numri i qytetarëve të Kosovës të cilët kanë votuar për kryetar komune, në total ka qenë gjithsej: 612.513. Pjesëmarrja në votime në Kosovë ishte 41.74% kurse gjithsej: 39.07%. Në Kosovë kanë votuar 607.022 veta. Fletëvotime përmes postës ish-in gjithsej 5.491. Gjatë votimit, janë numëruar 589.050 fletëvotime të vlefshme, ndërkaq 12.699 të pavlefshme ose 2.07%. Fletëvotime të paplotësuar, janë verifikuar 10.769 ose 1.76%.

¹⁴ Web faqja e KQZ-së

Demokracia në Veprim

Koalicioni Demokracia në Veprim është themeluar në vitin 2007 nga 11 organizata joqeveritare kosovare, shumica prej të cilave kishin përvojë të mëherëshme në monitorimin e zgjedhjeve. Demokracia në Veprim mbështetë promovimin e zgjedhjeve të lira si pjesën më thelbësore për një shoqëri demokratike. Objektivi kryesor i Demokracisë në Veprim është sigurimi i një procesi zgjedhor sipas standardeve universale për zgjedhje të lira te drejta dhe të barabarta dhe vëzhgim të paanshëm të procesit zgjedhore që inspiron besim tek qytetarët.

Anëtarët e Demokracisë në Veprim: CBM (mbulon Mitrovicën, Skenderajin dhe Vushtrinë); CCSD (mbulon komunat serbe në veri të Kosovës); CSD (mbulon Graçanicën dhe pjesët tjera të banuara me serbë në qendër dhe jug të Kosovës); Developing Together (mbulon një pjesë të Prishtinës, Lipjanin si dhe Drenasin); FID (mbulon Gjakovën, Malishevën dhe Rahovecin); INPO (mbulon Ferizajin, Shtimen, Kaçanikun dhe Hanin e Elezit); KCIC (mbulon Gji-lanin, Kamenicën dhe Vitinë); KDI aktualisht e udhëheq koalicionin dhe e mbulon rajonin e Prizrenit (Prizren, Dragash, Suharekë dhe Mamushë); Shoqata Nëna Terezë (mbulon një pjesë të Prishtinës, Podujevën, Fushë Kosovën dhe Obiliqin); KIPRED bënë monitorimin e mediave; Syri i Vizionit (mbulon Pejën, Istogun, Klinën, Deçanin dhe Junikun).

Përmes pjesëmarrjes së shoqërisë civile ky koalicion promovon: pjesëmarrjen në zgjedhje të lira përmes edukimit të votuesve, promovon te drejtën dhe obligimin e qytetarëve që të jenë pjesë e procesit zgjedhor, bashkëpunon me organizata vendore, rajonale dhe ndërkombëtare për ndërtimin e një procesi transparent dhe vëzhgim të procesit në mënyrë të paanshme si kontribut në avancimin e jetës demokratike në Kosovë.

Gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, Demokracia në Veprim ka angazhuar 10 koordinatore rajonal dhe 65 vëzhgues afatgjatë të cilët kanë monitoruar fushatën parazgjedhore të partive politike. Në ditën e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" ka pasur të angazhuar nga një vëzhgues në çdo vendvotim, sikurse ka pasur të angazhuar edhe rreth 150 vëzhgues mobil anembanë Kosovës.

Adresa:

Rr. "Rrexhep Mala" nr. 33
10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 248 038

E-mail: info@demokracianeveprim.org

Web: www.demokracianeveprim.org